

M.Sc. Luljeta Bajrami-Shala

**GJUHA URREJTËSE E NXËNËSVE NË  
MEDIET SOCIALE**

SI TA PARANDALOJMË

DORACAK PËR MËSUES

Prishtinë, 2016

**Botues:**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Autore:**

M. Sc. Luljeta Bajrami - Shala

**Redaktor i botimit:**

Ismet Potera

**Recensentë:**

Shaip Hasani, sociolog

Blerina Halilaj, psikologe

**Lektor:**

Bekim Morina

**Përgatitja teknike:**

Skender Mekolli

*Ky material është produkt i projektit hulumtues të realizuar nga IPK-ja. Materiali do të shërbejë si doracak për mësime dhe nxënës që të kenë informacione lidhur me gjuhën urrjetëse nga nxënës dhe pasojat. Është një ndihmë vetëdijesimi, duke iu ofruar mësimeve mbështetje se si të kontribuojnë për parandalimin e gjuhës urrjetëse nga nxënës në mediet sociale. Pjesëmarrësit dhe kontribuuesit meritojnë falënderim.*

## PËRMBAJTJA

SHKURTESAT .....	7
ABSTRAKT .....	11
HYRJE .....	14
I. KONTEKSTI TEORIK .....	16
1. Gjuha urrejtëse ‘online’ dhe ‘offline’ .....	17
2. Pasoja të dëmshme nga gjuha urrejtëse .....	18
3. Dallimi i gjuhës urrejtëse nga konceptet e përfaqëruara.....	19
3.1. Gjuha urrejtëse dhe diskriminimi nga nxënësit .....	19
3.2. Gjuha urrejtëse, ofendimi dhe shpifja.....	21
3.3. Gjuha urrejtëse e nxënësve në mediet sociale .....	22
3.4. Mediet dhe gjuha urrejtëse.....	24
3.5. Redaktorët e shkrimeve ose programeve televizive - përgjegjësit.....	26
4. Qasja në luftën kundër gjuhës urrejtëse.....	27
4.1. Studimet për ngacmimin dhe për mbrojtjen nga diskriminimi.....	31
4.2. Ngacmimi dhe udhëzimi sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut .....	36
4.3. Ngacmimet kibernetike.....	39
5. Relacionet e projektit me prioritetet zhvillimore të shtetit ...	49
II. METODOLOGJIA .....	51
2.1. Qëllimi i hulumtimit.....	52
2.2. Problemi hulumtues dhe arsyeja .....	53
2.3. Objektivat e përgjithshme dhe të veçanta .....	54
2.4. Metodatat e hulumtimit.....	55

2.5. Rezultatet e hulumtimit dhe interpretimi i tyre .....	57
2.5.1 Analiza e të dhënave të fituara nga pyetësi i nxënësve .....	57
2.5.2. Analiza e të dhënave të fituara nga pyetësi i mësimdhënësve .....	63
III. NË BAZË TË REZULTATEVE TË HULUMTIMIT, KËSHILLA TË PËRGJITHSHME PËR INTERNETIN.....	70
3.1. Ngacmimi seksual – Sajberdhuna (cyberbullying) .....	71
3.2. Rrjetet sociale .....	72
3.3. Postimi i fotografive dhe videove në internet .....	74
3.4. Telefoni celular .....	74
3.5. Lojërat në internet .....	75
3.6. Dhomat e diskutimit .....	76
3.7. Si pasojë e komunikimit në internet, rrjetet sociale vjen edhe deri te trafikimi i fëmijëve .....	76
3.8. Pasojat e trafikimit – abuzimi seksual ndaj fëmijëve...	78
3.9. Ngacmimet kibernetike, rrezik për fëmijët .....	79
IV. PËRFUNDIME .....	83
V. REKOMANDIME.....	84
VI. LITERATURA .....	86
SHTOJCA 1 .....	89

## *Parathënie*

*Gjuha si mjet më i vjetër, dhe i domosdoshëm, i komunikimit midis njerëzve ka qenë objekt i trajtimit nga autorë të ndryshëm, dhe në aspekte të ndryshme, si: semantike, morfologjike, etimologjike etj. Në popull janë të njohura shumë fjalë të urta, por me porosi të mprehta, për gjuhën, si: fjala vret, njëqind herë mendo, njëherë fol...*

*Botimi “Gjuha urrejtëse e nxënësve në mediet social” që po prezantojmë nuk merret as me letërsi popullore e as me çështje semantike të gjuhës, por me një aspekt të veçantë të përdorimit të saj, dhe atë në mediet sociale: gjuhën urrejtëse. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë sot ka tejkaluar prëmasat dhe parashikimet e futuristëve. Njësoj po ndodhë edhe me zhvillimin edhe të medie sociale, të cilat kanë ndikuar në masë të madhe në lehtësimin e komunikimit midis njerëzve, por njëkohësisht ka shtuar edhe mundësinë e keqpërdorimit të tyre në raportet midis njerëzve.*

*Duke pasur parasysh moshën e fëmijëve, adoloshencës sidomos, këto medie janë bërë një problem shqetësues me përmasa globale. Mundësitë e keqpërdorimit të tyre, qoftë nga fëmijët qoftë nga abuzuesit e ndryshëm janë shumë të pranishme jo vetëm te ne në Kosovë por gjithandej. Ka plotë raste të bartjes së konflikteve nga bisedat nëpërmjet fcb, mesenger, forumet e ndryshme, viber... deri në rrugë, shkollë e gjetiu me përfundime fatale.*

*Pikërisht ishin këto shqetësime, sidomos të shprehura vitet e fundit, që e shtynë autoren Shala për ta trajtuar këtë çështje si në aspektin teorik ashtu edhe në aspektin e identifikimit të dukurisë në mjedisin social, siç është shkolla.*

*Sot janë të njohura shumë konventa, ligje e akte të tjera nënligjore të cilat mëtojnë ta luftojnë dhunën ndaj fëmijëve, si atë fizike ashtu edhe verbale. Ngacmimet nëpërmjet medieve sociale, si formë e dhunës verbale, psikologjike etj., janë bërë pjesë e komunikimit midis të rinjve dhe fëmijëve të moshave të ndryshme. Këtë e dëshmon e dhe pjesa nga hulumtimi si pjesë e këtij libri.*

*Autorja nuk pretendon që të gjejë formula a zgjidhje shteruese për parandalimin e gjuhës urrejtëse në mediet sociale, por më tepër një ndezje alarmi për këtë dukuri që po përhapet mes nxënësve. Çështjet e trajtuara, shembujt e përzgjedhur dhe udhëzimet për veprim janë një material i vlefshëm si për mësuesit ashtu edhe për prindërit dhe për nxënësit që ta shmangin një dukuri të këtillë.*

*Pra le të shërbej ky doracak si një udhërrëfyes për të gjithë ata që janë të shqetësuar nga një dukuri e këtillë, sidomos nga mësuesit që duhet ta luftojnë këtë dukuri të keqe. Shembujt e përmendur në libër janë të mjaftueshëm për mobilizim të të gjitha akterëve për zbutjen e problemit. Një gjë nuk duhet harruar secili nga ne një ditë mund të gjendemi një një situatë të tillë qoftë si prindër, mësues apo qytetar i përgjegjshëm i këtij vendi. Më mirë të parandalohet se sa të shërohet!*

*Ismet Potera*

## **SHKURTESAT**

SHMU-Shkollë e Mesme e Ulët

BE-Bashkimi Evropian

KEDNJ-Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

GJEDNJ-Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

GJED- Gjykata Evropiane e Drejtësisë

UNESKO-United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization

ECRI-European Commission against Racism and Intolerance

KE-Këshilli i Evropës

FIT- Qendra për Studime të Avancuara

MASHT-Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

TIK-Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit

PSAK-Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë

KKK-Korniza e Kurrikulit të Kosovës

## **ABSTRACT**

In recent years we have seen a huge increase in the use of internet, online communication and dissemination of information in our country. It increases the speed with which Internet use is stunning. We have a very large increase of its use at work, school and course in life.

Using the Internet has brought a range of benefits to society by reducing geographical distances and facilitating the dissemination of information to the maximum. Many psychologists believe that the Internet has brought a distinct sense of community life. The Internet has brought a number of benefits for children and young people, facilitating their social contacts, improving writing and language.

The Internet allows us to create, publish, distribute and consume media content by allowing space for full participation, commitment and self-expression.

With the development of social networks, everyone can participate in the Internet space in many different ways, from maintaining contacts with society and creating new contacts, to distribution of content and research of self-expression.

This online space gives us new opportunities, joint commitment with other people who have the same cause. Language as such hatred is not new to the Internet, as in debates on human rights. Its online dimension and potential damage on democratic processes gives us reason to act. Media helps strengthen existing images or stereotypes in society. In this regard through media monitoring we come across shortcomings and errors, which can then be used to develop a model of its behavior in order to



prevent the use of hate speech. Such a model would also help us to support dialogue and living together; prevention of conflicting positions, or even the appearance of security crises in the region.

But beyond the great benefits that come from using the Internet, the rapid development of technology, the growth of online services and other applications, unfortunately, we must recognize that this increase in use is not accompanied by the necessary measures to be protected from the dangers this technology especially for children.

For today is the development and distribution of internet goes much faster than safeguards from its misuse. I would like to enumerate the consequences and risks that use of the Internet brings and for children in particular, because this was the impetus for the research carried out in some schools in Kosovo: First, there is a risk too big for sexual harassment online, is existing hateful speech that then promotes mental and physical violence to children. The focus of the topic would be hateful speech/language online and offline for students in lower secondary school in Kosovo.

KPI Survey were conducted in five schools in four municipalities in Kosovo. The survey were conducted during the school year on 2014 - 2015. In this research was reviewed relevant literature on this issue and the data derived from the survey were processed, analyzed and prepares a research report.

In the first chapter they are given information about hateful language as a concept, the consequences of hate speech, the approximate difference of language concepts averse. Theoretical context and also contains an analysis of the legislation and national and international documentation harassment language

documents that is regulated no hate speech and protection from hate speech .

The second chapter described the research methodology and results of the research.

The third chapter some general tips based on findings from the research.

Recommendations and conclusions in an annex to the glossary that explains the various concepts used in the study.

Keywords: hate speech online, media, information, discrimination, insult comments online,

## **ABSTRAKT**

Në vitet e fundit kemi parë një rritje shumë të madhe të përdorimit të internetit, komunikimit 'online' dhe shpërndarjes së informacionit në vendin tonë. Shpejtësia me cilën është rritur përdorimi i internetit është mahnitëse. Kemi një rritje shumë të madhe të përdorimit të tij në punë, shkollë, dhe padyshim në jetën e përditshme.

Përdorimi i internetit ka sjellë një sërë përfitimesh për shoqërinë, duke reduktuar distancat gjeografike dhe duke lehtësuar në maksimum shpërndarjen e informacionit. Shumë psikologë mendojnë se interneti ka sjellë një frymë ndryshe në komunitet. Interneti ka sjellë një sërë përfitimesh për fëmijët dhe të rinjtë, duke lehtësuar kontaktet sociale ndërmjet tyre dhe duke përmirësuar shkrimin dhe gjuhën.

Interneti dhe në përgjithësi mediet sociale mundësojnë të krijojmë, të publikojmë, të distribuojmë dhe të konsumojmë përmbajtje të mjaftueshme mediave, ngase mundësojnë hapësirë për pjesëmarrje të plotë, angazhim dhe vetëshprehje.

Me zhvillimin e rrjeteve sociale, të gjithë mund të marrim pjesë në hapësirën e internetit në shumë, mënyra të ndryshme, nga mirëmbajtja e kontakteve me shoqërinë dhe krijimin e kontakteve të reja, deri tek shpërndarja e përmbajtjeve dhe hulumtimit të vetë shprehjes.

Kjo hapësirë në internet na jep mundësi të reja: angazhim të përbashkët me njerëz të tjerë, të cilët kanë kauza të njëjta. Gjuha urrejtëse, si e tillë nuk, është risi në internet, as në debatet për të drejtat e njeriut. Dimensioni i saj në internet dhe dëmi potencial

mbi proceset demokratike na japin arsye të veprojmë. Mediet ndihmojnë në përforsimin e imazheve apo edhe stereotipeve ekzistuese në shoqëri. Në këtë aspekt, nëpërmjet monitorimit të mediave, ne mund të hasim mangësitë dhe gabimet, të cilat mund të shërbejnë më pas për të zhvilluar një model të sjelljes së saj, me qëllim parandalimin e përdorimit të gjuhës urrejtëse. Një model i tillë do të na ndihmojë po ashtu të mbështesim dialogun e të jetuarit së bashku, parandalimin e qëndrimeve konfliktuese, apo edhe shfaqjen e krizave të sigurisë në rajon.

Por, përtej përfitimeve të mëdha, që vijnë nga përdorimi i internetit, zhvillimi i shpejtë i teknologjisë, rritja e shërbimeve në internet dhe aplikacioneve të tjera, për fat të keq, duhet të pranojmë se kjo rritje në përdorim nuk është shoqëruar me masat e nevojshme për t'u mbrojtur nga rreziqet që sjell kjo teknologji, veçanërisht për fëmijët.

Është fakt që zhvillimi dhe shpërndarja e internetit ecën shumë më shpejt se masat mbrojtëse nga keqpërdorimi i tij. Do të doja të rendisja pasojat dhe rreziqet që përdorimi i internetit sjell, për fëmijët në veçanti, ngase kjo ishte dhe shtytje për hulumtimin e realizuar në disa nga shkollat e Kosovës. Së pari, ekziston një risk shumë i madh për ngacmime seksuale në internet, ekziston gjuha urrejtëse, që pastaj nxit dhunën psikike, por edhe fizike, te fëmijët. Fokusi i temës do të jetë në gjuhën urrejtëse 'online' dhe 'offline' nga nxënësit në shkolla të mesme të ulëta në Kosovë.

Hulumtimi nga IPK-ja u realizua në pesë shkolla, në katër komuna të Kosovës. Hulumtimi u realizuar gjatë vitit shkollor 2014 - 2015. Për këtë botim u shqyrtua literatura përkatëse lidhur me këtë çështje dhe të dhënat e dala nga hulumtimi u përpunuan, u analizuan dhe u përgatit raporti i hulumtimit.

Në kapitullin e parë janë dhënë informata lidhur me gjuhën urrejtëse si koncept, pasojat që vijnë nga ajo, dhe dallimi nga konceptet e përafërta të gjuhës urrejtëse. Poashtu, konteksti teorik përmban edhe një analizë të legjislacionit dhe dokumentacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, për ngacmimet nga gjuha urrejtëse dhe mbrojtja me dokumentet zyrtare nga ajo.

Në kapitullin e dytë përshkruhen metodologjia hulumtuese dhe rezultatet e dala nga hulumtimi.

Kapitulli i tretë përmban disa këshilla të përgjithshme, bazuar në gjetjet nga hulumtimi.

Dhe, në fund jepen përfundimet dhe rekomandimet, me një shtojcë të fjalorthit, ku sqarohen konceptet e ndryshme të përdorura në studim.

**Fjalë kyçe:** gjuhë urrejtëse, media ‘online’, informim, diskriminim, komente fyese ‘online’

## HYRJE

Liria e fjalës dhe e shprehjes së mendimit paraqet të drejtën themelore të njeriut, e cila ka rol thelbësor në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera. Mundësi për t'u shprehur mendimi dhe për t'u shkëmbyer informacioni paraqet tregues të vlefshëm për kapacitetin demokratik dhe pozicionin institucional të demokracisë në shoqëri. Konceptet e qytetarisë dhe të pluralizmit janë të porealizueshme pa mundësinë e shprehjes së lirë të mendimit dhe garës objektive të ideve të kundërvëna politike. Toleranca ndaj mendimit të tjetrit dhe të ndryshmit mundëson bashkë-ekzistencë në shoqëritë bashkëkohore shumë-kulturore. Mirëpo, liria e shprehjes mund të keqpërdoret në situata të caktuara dhe e njëjta kalon në dukuri, e cila është e kundërta e plotë e saj. Persona dhe grupe të caktuara mund të shprehin ide për superioritet të një race, religjioni ose kombi të caktuar, me qëllim që t'i përçmojnë të gjithë ata të cilët nuk i takojnë grupit “të tyre”, si dhe të bëjnë thirrje për ndjekje e izolim, madje edhe deri për gjenocid. Në raste të këtilla, liria e shprehjes interpretohet gjerë e gjatë dhe kalon në gjuhën urrejtëse. Këto dukuri e aktualizuan diskutimin për lirinë e shprehjes, kufizimet e saj dhe keqpërdorimin e kësaj lirie. “Në mediat tona dhe në gjendjen e tranzicionit, të kulturës së ulët të fjalës dhe përdorimit të saj, nxitja dhe përhapja publike e urrejtjes së këtyllë, pa ndjenjë të përgjegjësisë për fjalën e thënë, paraqitet sigjenerator kryesor i klimës shoqërore, mostolerancës dhe paragjykimeve mbi baza nacionale, etnike dhe të tjera, e cila shfaqet në kuadrin e përgjithshëm psikologjik për ekspansionin e të gjitha formave të

veprave të urrejtëse – nga veprat e dhunës fizike deri te veprat e dhunës verbale dhe psikike”.

Mjetet e ndryshme digjitale: interneti, telefonat mobilë, video-lojërat, u mundësojnë fëmijëve dhe të rinjve qasje në nxjerrjen e informatave të rëndësishme në fusha të ndryshme, shkollim, dije, komunikim, zbavitje e shumë gjëra të tjera, të cilat vështirë se do të mendoheshin vite më parë. Shumë informata madje mund të arrihen pa u përfillur moshë. Nisur nga ky fakt, del se një numër i madh i fëmijëve as që mund ta mendojnë jetën e tyre pa profil në rrjetin social; të shpërndarjes së fotove, lojërave dhe mesazheve të ndryshme<sup>1</sup>.

Shumë nga ta bëjnë dhe hapjen e profileve, duke dhënë të dhëna personale jo të sakta, ngase nuk u jepet e drejta nën moshën 18-vjeçare. Në Kosovë gjendja është alarmante, ngase edhe fëmijët e moshave mjaft të vogla kanë të hapur një faqe profili në ‘Facebook’ dhe nga kjo del se fëmijët mund të abuzohen qoftë ‘online’ dhe pasojat pastaj t’i kenë në jetën reale.

Në shoqëritë shumëkulturore, të cilat karakterizohen nga një shumëllojshmëri e kulturave, feve dhe stileve të jetës, ndonjëherë është më se e nevojshme të respektohet e drejta e lirisë së shprehjes dhe të drejtat e tjera, si e drejta e lirisë së mendimit, ndërjegjes dhe e fesë, apo e drejta për të qenë i lirë nga diskriminimi.<sup>2</sup> Ky barazim mund të bëhet një burim i problemeve, për shkak se këto të drejta janë të gjitha elementet themelore të një "shoqërie demokratike".

---

<sup>1</sup> Projekt hulumtues i realizuar në kuadër të shkollës ‘Mihajl Grameno’, “DHUNA NË SHKOLLË” studim rasti, Prishtinë, janar 2014.

<sup>2</sup> Zguri, Rrapo “Publiku në udhëkryqin media klasike – internet”, Linku: <http://mediapermedian.wordpress.com/2012/11/27/publikuar-në-krqëzimin-media-klasike-internet/prill-2015>.

## I. KONTEKSTI TEORIK

Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuar në nenin 1 të Ligjit nr. 05/L-021, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësojë ose të cenojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet e tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës - Liria e Medieve- Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Çdokush ka të drejtë të korrigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin.<sup>3</sup>

Qëllimi Ligjit nr. 05/L -021-LIGJ PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI<sup>4</sup> është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit

---

<sup>3</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008. neni 3, nenet 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56.

<http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

<sup>4</sup>Ligji PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, Kuvendi i Republikës së Kosovës; Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L -021 .28 maj 2015



fetar, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.

## **1. Gjuha urrejtëse ‘online’ dhe ‘offline’**

Liria e shprehjes, në kontekstin e saj, mundëson shkëmbim idesh dhe pluralizëm(vlera)që të realizohet pasuria e mendimit dhe përmes komunikimit të realizohen demokracia dhe diskursi politik. Prandaj, edhe kufizimet e saj duhet të kalojnëpërmes një filtri të rreptë, me qëllim që e njëjta të mos rrezikohet apo abuzohet.Gjuha e urrejtëse hap probleme të pakëndshme dhe komplekse për shoqëritëbashkëkohore, të cilat i janë përkushtuar respektit dhe kultivimit të pluralizmit kulturor dhe tolerancës.<sup>5</sup>Debatet rreth gjuhësurrejtëse sot, gjithnjë e më shumë, janë edhe reaksione të diskutimeve aktuale rreth migracionit në rritje, përkushtimit ndaj pluralizmit dhe respektimit të diversiteteve në demokracitë bashkëkohore, kushtetuese.Gjuha urrejtëse nënkupton manifestim të urrejtjes ndaj një grupi të caktuar.

Sipas rekomandimit nr. R (97) 20 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për “gjuhën urrejtëse”, liria e shprehjes dhe gjuha urrejtëse trupore ose mendore<sup>6</sup>,gjuha urrejtëse është një lloj

---

<sup>5</sup>KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN, UDHËRRËFYESI I DREJTAVE TË NJERIUT I BE-së PËR LIRINË E SHPREHJES ONLINE DHE OFLINE, Mbledhja e Këshillit të Punëve të Jashtme, Bruksel, 12 maj 2014.

<sup>6</sup>BOOKMARS -A MANUAL FOR COMBATING HATE SPEECH ONLINE THROUGH HUMAN RIGHTS EDUCATION B,Written and edited by Ellie

i të shprehurit, e cila është dizajnuar që të promovojë urrejtje në bazë të racës, religjionit, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, gjinisë, orientimit seksual, prejardhjes klasore/sociale etj. Studimet të kësaj fushe janë realizuar në vende të ndryshme të Evropës dhe mbi bazën e tyre është duke u realizuar fushata kundër gjuhës urrejtëse në vendet e BE-së<sup>7</sup>.

## **2. Pasoja të dëmshme nga gjuha urrejtëse**

Gjuha e urrejtëse shkakton dëm të madh si ndaj një individi konkret, përkatësisht grupit të cilit i adresohet, ashtu edhe ndaj shoqërisë në tërësi.

Gjithashtu shkakton dhimbje emocionale dhe psikike te viktimat, ndikon mbi mobilizimin shoqëror dhe prosperitetin gjatë punës. Përgjigjet psikike të këtyre sulmeve verbale përbëhen nga ndjenja e përçmimit, izolimit, urrejtjes së vetvetes dhe dyshimit ndaj vetvetes. Personi i afektuar mund të reagojë duke e kërkuar shpëtimin në alkool, drogë ose në lloje të tjera të sjelljes antisociale. Në mënyrë plotësuese, përçmimi te personi mund të manifestohet me simptoma të atilla shoqërore si qasje ndaj të qenit prind, qasje e cila fëmijës ia zvogëlon vetëbesimin dhe e konfirmon pritshmërinë e mospërfitimit shoqëror. Këto simptoma mund të rezultojnë nga përçmimi që e përmban gjuha urrejtëse.

Gjuha urrejtëse cenon “tregun e ideve”, mjedisin arsimor dhe idealin e barazisë - trajtimin e barabartë dhe parimin e mosdiskriminimit, që janë fundamentale për çdo shoqëri demokratike. Gjuha urrejtëse nuk bart me vete domethënietjetër,

---

Keen, Mara Georgescu Final editing Rui Gomes, Printed in Hungary ISBN 978-92-871-7840-4 © Council of Europe, 2014, f.133.

<sup>7</sup><http://nohate.ext.coe.int/Campaign-Tools-and-Materials> , Prill 2015.

përveç qëndrimit për mosbarazi esenciale ndërmjet njerëzve, ajo është njëformë e përjashtimit shoqëror dhe politik, deklaratë e armiqësisë ndaj një pjese të qytetarëve në shoqëri.<sup>8</sup>

Gjuha urrejtëse në mënyrë potenciale çon drejt krimit nga urrejtja, ndërkaqgjithashtu mund të çojë edhe në drejtim të gjenocidit. Kur një grup i caktuar do të përçmohet ose do të degjenerohet dhe me gjuhën e këtillë do të mbahet jashtë “komunitetit të të barabartëve”, ajo lehtësisht mund të bëhet objekt i sulmeve fizike dhe dhunës. Po ashtu, klasifikimi ose simbolizimi i mbështetur mbi gjuhën është njëri nga hapat e matshëm drejt gjenocidit.

### **3. Dallimi i gjuhës urrejtëse nga konceptet e përfaqëruara**

#### **3.1.Gjuha urrejtëse dhe diskriminimi nga nxënësit**

Inkriminimi i gjuhës urrejtëse në përgjithësi ndërlidhet me racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin, shovinizmin, homofobinë, di dhe me konceptin ediskriminimit.Diskriminimi duhet të kuptohet si një veprim ndryshe ndaj personit/grupit në situata të ngjashme, të bëra pa arsye objektive ose të justifikueshme. Koncepti i diskriminimit domethënë i referohet trajtimit më pak të favorshëm të personit,sipas ndonjë baze të ndaluar, si prejardhja racore ose etnike, gjinia etj. Ndërkaq, gjuha urrejtëse, si gjuhë që përhap urrejtje, mund të përmbajë

---

<sup>8</sup>Preventing and Responding to Hate Crimes: A Resource guide for NGOs in the OSCE region, OSCE/ODIHR; Published by the OSCE’s Office for Democratic Institutions and Human Rights (ODIHR) Aleje Ujazdowskie 19 00-557 Warsaw Poland, www.osce.org/odihhr © OSCE/ODIHR 2009.

veprimin/thirrjenose nxitjen e diskriminimit, ndërkaq po ashtu edhe vetë gjuhaurrejtëse mund të paraqesë/nënkuptojë dhe të trajtohet si diskriminim. Për shembull, në rastin ‘Aksu’kundër Turqisë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke vlerësuar se a ekzistojnëelemente që rasti të shqyrtohet nga aspekti i ndalimit të diskriminimit, përcaktonte nëse publikimet përkatëse përfshinin shprehje dhe vërejtje me të cilatmanifestohen ndjenja antirome dhe kishin “qëllime diskriminuese ose pasoja tëtilla”.<sup>9</sup> Kjo do të thotë se në luftën kundër gjuhës urrejtëse, në kontekst kombëtar, nëmënyrë efektive mund të përdoren edhe dispozitat e Ligjit për parandalimin dhembrojtjen nga diskriminimi nga viti 2010, më konkretisht neni 9, i cili ndalon thirrjedhe nxitje të diskriminimit dhe neni 7, i cili ndalon veprime që shqetësojnë dhepërçmojnë, e që paraqet cenim të dinjitetit të personit ose të grupit të personave,që rezulton nga baza diskriminuese dhe që ka për qëllim ose si rezultat cenimin edinjitetit të një personi të caktuar ose krijimin e një mjedisi, qasjeje ose praktikekërcënuese.<sup>10</sup>

---

<sup>9</sup>Hate Crime Laws: A Practical Guide, Published by ODIHR, Warsaw, Poland, Aleje Ujazdowskie 19 00-557 Warsaw Poland, [www.osce.org/odihhr](http://www.osce.org/odihhr) © OSCE/ODIHR 2009.

<sup>10</sup>Manual për Ligjin Evropian të Mbrojtjes nga Diskriminimi, korrik 2010. Ky përkthim u mundësua në kuadër të Projektit të Përbashkët mes Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, i titulluar « Përforcimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë’\* © Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore të Njeriut, 2010. Këshilli i Evropës, 2010.

### 3.2. Gjuha urrejtëse, ofendimi dhe shpifja

Gjuha e urrejtëse ndalohet për shkak të cenimit që e bën. Ajo, para së gjithash, ecenon dinjitetin e individit si pjesëtar i grupit. Ndërkaq, cenimi i dinjitetit të individit mund të karakterizohet thjesht si ofendim dhe shpifje. Ofendimi dhe shpifja janë një ves i keq shoqëror, për shkak të dëmit që shkaktojnë në sytë e të tjerëve.<sup>11</sup> Kjo e dëmton statusin shoqëror të tyre dhe edëmtojnë reputacionin. Për dallim nga ofendimi dhe shpifja, gjuha urrejtëse përçmon individin edhe për shkak të ndonjë karakteristike të caktuar, e cila nuk guxontë perceptohet si e papranueshme në shoqëri (raca, gjinia, përkatësia etnike, religjioni) që do të thotëvetërespektimi i saj është shkelur.<sup>12</sup> Në rastet kur, për shembull, një person deklaron publikisht se ndonjë person tjetër është i pandershëm, jointeligjent ose i pamoralshëm, personi tjetër me këtë deklaratë mund ndihet i ofenduar, por nëse të gjitha këto të dhëna publikeddo të lidhen me karakteristikat e identitetit të tij (si për shembull: përkatësia etnike, gjinia ose orientimi seksual) ai person është ofenduar në një mënyrë dhe ndihet i poshtëruar. Situatë identike haset edhe te dallimi midis gjuhës urrejtëse dhe shpifjes. Kur një person për një person tjetër shpreh fakte të pavërteta, përpara personave të tretë, kjo mund të jetë shpifje, por nëse ato fakte të pavërteta kanë për qëllim ta deskreditojnë sa i përket natyrës së tij të veçantë, atëherë bëhet fjalë për gjuhë urrejtëse.

---

<sup>11</sup> LIRIA E SHPREHJES DHE GJUHA E URREJTJES, Autorë: dr Elena Mihajlova, dr. Jasna Bačovska, mr. Tome Shekerxhiev, Shkup, 2013, f 33.

<sup>12</sup> The Camden Principles on Freedom of Expression and Equality, April, 2009.

### 3.3. Gjuha urrejtëse e nxënësve në mediet sociale

Interneti, me gjithë aktualitetin që ka, është shndërruar edhe në mjet për përhapjen e urrejtjes, nga e cila pastaj lindin edhe probleme dhe konflikte sociale me pasoja. Anonimiteti dhe mobiliteti, që ie siguron ky mjet komunikimi, e bëri të lehtë shprehjen e gjuhës urrejtëse në një hapësirë shumë të gjerë, e cila del jashtë fushës së aplikimit tradicional të së drejtës. Megjithatë, mesazhi i urrejtjes mund të arrijë, për një kohë të shkurtër, tek miliona njerëz përmes rrjetit, i cili grupeve të ndryshme, paraprkasht të fragmentizuara në mënyrë plotësuese, u mundëson të lidhen, duke gjeneruar ndjenjën e komunitetit dhe identitetit të përbashkët.

Në përpjekjet për luftimin e përhapjes së gjuhës urrejtëse në internet, Këshilli i Evropës në vitin 2001 miratoi Konventën për Krimin në Fushën e Kibernetikës, që është marrëveshja e parë multilaterale, e cila angazhohet për luftimin e krimit kibernetik dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet shteteve, duke i harmonizuar ligjet dhe teknikat hetimore për ta luftuar një dukuri të tillë.

Hapësira në internet është duke u bërë gjithnjë e më e rëndësishme për të gjitha aspektet e jetës njerëzore, duke përfshirë zonat sociale, arsimore, ekonomike dhe politike. Prandaj, edhe rëndësia e saj është duke u bërë më e dukshme për organizatat paqësore dhe OJQ-të e tjera.

Shoqëria me shpejtësi shumë të madhe është duke lëvizur në epokën digjitale në internet, gjë që imponon organizimin e projekteve dhe programeve, duke komunikuar me njëri-tjetrin për ngritjen e vetëdijes të përgjithshme shoqërore, për luftimin e gjuhës urrejtëse në medie.

Megjithatë, hapësira kibernetike është e re për ne, prandaj dhe duhet edukuar veten për aftësinë e këmbimit të informacioneve dhe thellimin e njohurive në lidhje me këtë revolucion të komunikimit. Edhe pse mundësitë për të mësuar dhe shkëmbyer informata dhe ide janë gati të pafundme dhe do të vazhdojnë të rriten, sasia e informacionit masiv që rrjedh në internet dhe gjithashtu në postën tonë elektronike na sfidon që të krijojmë një kulturë pozitive të dialogut në internet.

Edhe në Kosovë, sipas **Kodit Penal të Republikës së Kosovës, neni 147<sup>13</sup>**, nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik është e ndaluar. Kushdo që nxit ose përhapublikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe të tjera të tilla, që jetojnë në Republikës e Kosovës, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 5 vjet.

Në Kosovë ka ngacmime virtuale tek të rinjtë. Kjo është dëshmuar në shumë shkrime /intervista, nga psikologë e sociologë, lidhur me prezencën e kësaj dukurie dhe pasojat nga kjo dukuri. Kërcënuesit/ngacmuesit virtualë përdorin teknologjitë e reja për të bërë kërcënime, për të shkaktuar frikë, për të bezdisur, përfolur dhe përjashtuar të rinjtë dhe, në disa raste, për t'i depersonalizuar ata apo për të vjedhur identitetin e tyre. Disa nga mënyrat më të zakonshme të kërcënimit janë: kërcënim nëpërmjet mesazheve, shqetësim/telefonata të rreme, publikimi dhe shpërndarja e imazheve pa lejen e fëmijës suaj, *e-maile dhe mesazhe në kohë reale (IM)*, kërcënimet në faqen e chat-it apo në

---

<sup>13</sup> GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.19 / 13 KORRIK 2012, PRISHTINË, KODI NR. 04/L-082 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

forume, kërcënimi nëpërmjet një rrjeti social, kërcënimi gjatë lojërave interaktive në grup etj.

### **3.4. Mediet dhe gjuha urrejtëse**

Në vitin 1978 UNESCO e miratoi Deklaratën për Parimet Themelore në lidhje me kontributin e medieve për përforcimin e paqes dhe mirëkuptimit ndërkombëtar, për avancimin e të drejtave të njeriut dhe për kundërshtimin e racizmit dhe nxitjes së luftës<sup>14</sup>. Mediet nuk mund t'i kualifikojmë si kreatorë të gjuhës urrejtëse, por ato janë instrument, kanal dhe mjete për përhapjen e së njëjtës. Ato, gjithashtu, mund të krijojnë kontekst, situata dhe klimë të volitshme për përhapjen e urrejtjes ose estetizimin e së njëjtës. Sistemi mediatic gjithnjë e më shumë bëhet njëri nga kriteret e demokracisë së një shoqërie, përdorimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Se si është vendosur sistemi mediatic në një shtet varet edhe nga standardet profesionale dhe kushtet e veprimit të medias, por është shumë e rëndësishme edhe kultura mediatiche, e cila varet drejtpërdrejt nga kultura politike. Analizat dhe debatet rreth demokratizimit të sistemeve mediatiche janë të orientuar në dy drejtime: strukturimin e sistemeve mediatiche dhe keqpërdorimin e komunikimeve përmes mënyrave dhe teknikave me të cilat formohet dhe krijohet opinioni publik dhe të kuptuarit e qytetarëve, me qëllim të fitimit dhe ruajtjes së pushtetit. Qëllimet strategjike të tipit evropian të sistemit mediatic janë:

---

<sup>14</sup>Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes, autorë: dr Elena Mihajlova, dr. Jasna Baçovska, mr. Tome Shekerxhiev, Shkup, 2013, (Deklarata për Parimet Themelore për Kontributin e Mediave në Përforcimin e Paqes dhe Mirëkuptimit Ndërkombëtar, për Avancimin e të Drejtave të Njeriut dhe Luftimit me Racizmin, Aparthedin dhe Nxitjen e Luftës, UNESCO, 1978 ).



- Sistemi mediatik i mbështetur në Qendrën kualitative radio-difuzivepublike;
- Pluralizmi i medieeve;
- Garancia e pavarësisë së medieeve;
- Inkorporimi i standardeve në profesionin e gazetarisë, përkatësishtprofesionalizimi dhe intelektualizmi i gazetarit.

Në legjislacionin që rregullon mediet ligjvënësit mund të parashikojnë trupanacionalë për monitorim, siç janë: Këshillat për shtyp ose medie, me të cilët do të rregullohen çështjet e mediave, që zakonisht përbëhen nga ekspertëose përfaqësues të shoqërisë civile. Në mënyrë që të rregullohet sistemi mediatik,doemos duhet të vendosen standarde për kualitet, si dhe të mbështetetdhe stimulohet konkurrenca. Shteti mund të kërkojë licenca të caktuara, të cilatduhet të lëshohen në bazë të mosdiskriminimit. Zbatimi i monitorimit nga ana ështëit duhet të realizohet nëpërmjet shumë mekanizmave.Organizatrat profesionale, si Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve, Instituti Ndërkombëtar për Shtyp dhe Asociacioni Ndërkombëtar i Botuesve, kanë informatagjithëpërfshirëse për gjendjen me lirinë e mediave në shtete dhe rajone tëndryshme të botës dhe i mbështetin anëtarët e tyre kundër kufizimeve. Po ashtu, ata vëmendje të veçantë u përkushtojnë situatave ku këto liri lihen pasdore, nëmënyrë që të lansohen fushata ose aksione të shpejta ankimuese dhe të përgatisinraporte për probleme të caktuara, si koncentrim dhe transparencë mediatikesipas lirisë së rregullimit informatik ose korrupsionit. Në këtë segment, ata mbështeten nga organizata civile, të cilat janë të specializuara për lirinë e shtypitdhe medie, si organizata e përmendur në “nenin 19” për raportues pa kufij, sidhe organizatat joqeveritare të cilat si fushë interesi dhe të

punës i kanë të drejtat universale të njeriut, siç është ‘Amnesty International, International Council on Human Rights Policy’ etj.

### **3.5. Redaktorët e shkrimeve ose programeve televizive-përgjegjës**

Gjuhaurrejtëse dhe e shprehjes, që përmbajnë elemente të saj, kanë ndikim më të dëmshëm nëse përhapen përmes mediave, e që në mënyrë plotësuese e shtojnë përgjegjësinë e gazetarëve. Gazetarët vazhdimisht shkruajnë për diversitetet, për dallimet, të cilat bazohen mbi religjionin, racën, gjininë, përkatësinë seksuale, prejardhjen sociale, kulturën. Vlerat dominuese patriarkale dhe konservative, gjithashtu, ndikojnë edhe mbi punën e gazetarëve. Si perceptim i përgjithshëm mund të theksohet se redaktorët e shkrimeve ose programeve televizive-përgjegjës kryesisht kanë kujdes në ndarjen mbi bazë etnike dhe religjioze, ndërkohë që mund të vërehen tendenca të shprehura diskriminuese mbi bazë të gjinisë dhe orientimit seksual.

Në këtë drejtim, gjithashtu, bëhen përpjekje në planin ndërkombëtar për eliminimin e joprofesionalizmit të gazetarëve. Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve i obligon gazetarët me kodeksin etik për humanizëm dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut. Nga gazetari pritet ndërgjegjësim në lidhje me përgjegjësinë e punës.

#### 4. Qasja në luftën kundër gjuhës urrejtëse

Gjuhaurrejtëse shkakton dëm të madh, si tek individët konkretë, të cilëve u adresohet shprehja, ashtu edhe në shoqëri në përgjithësi. Ajo e cenon idealin e barazisë ose trajtimin e barabartë të mosdiskriminimit, e që janë të njërendësie fundamentale për çdo shoqëri demokratike. Gjuha urrejtëse ka ndikim të dëmshëm mbi rendin, qetësinë dhe cilësinë shoqërore të jetës në shoqëri. Kjo gjuhë ka kapacitet që seriozisht ta dëmtojë strukturën sociale dhe t'i ndajë komunitetet. Dhe, përfundimisht, gjuha urrejtëse potencialisht çon drejt krimit nga urrejtja dhe gjithashtu mund të çojë edhe në drejtim të gjenocidit. Duke e pasur parasysh dëmin, të cilin e shkakton gjuha urrejtëse, është e qartë pse rregullimi i saj është pranuar në mënyrë universale, në kuptimin e ndëshkimit të saj në shkallë të ndryshme. Përvoja evropiane shkon në drejtim të përforcimit të parimit të mosdiskriminimit me të drejtën që të mos diskriminohet (protokolli i 12-të i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut)<sup>15</sup> dhe me përpjekjen për zgjerimin e institutit “promovim i barazisë”. Këto dy institute kërkojnë aktivitet shumë më të madh të shtetit në eliminimin e formave më suptile të diskriminimit të tërthortë dhe krijimit të kushteve për barazi efektive të mundësive. Kjo veçanërisht pasqyrohet në gjuhënurrejtëse, në kontekst të ndjeshmërisë shumë më të madhe për rreziqet e shprehjeve publike, të cilat përmbajnë mostolerancë dhe ksenofobi (shih në rekomandimet e ECRI,

---

<sup>15</sup>KONVENTA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, korrik 2010. Bashkimi Evropian do të aderojë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe në KEDNJ. Kjo do ta vendosë BE-në nën mbikëqyrjen e organeve të jashtme monitoruese dhe individët do të jenë në gjendje të ankohen për shkelje të KEDNJ-së nga BE-ja direkt përpara GJEDNJ-së.

Këshilli i Evropës). Përvoja evropianepranon të përfshihet në zgjidhjen juridike të të drejtave të mbivendosura:në të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të drejtën e mosofendimit mbi bazë etnike dhe kulturore. Dhe, në mënyrë plotësuese, kjo “zgjidhje juridike” rezulton nga qëndrimi përparandashmërinë dhe universalitetin e të drejtave të njeriut, me të cilin konfirmohet marrëdhënia afirmative ndërmjet lirisë së shprehjes dhe barazisë. Përkatesisht, liria e shprehjes dhe barazia kanë kontribut komplementar dhe thelbësor në sigurimin dhe mbrojtjen e dinjitetit të njeriut. Së këtejmi, “ngushtimi” i lirisës së shprehjes me ndalimin e gjuhësurrejtëse mundësojnë hapësirë më të madhe sociale për lirinë e shprehjes të të gjitha grupeve në shoqëri, përkatësisht mundëson debat dinamik me aspekte të ndryshme me interes publik, i cili theksinë vë mbi perspektivat dhe këndvështrimet e ndryshme. Dhe, e kundërta, kurgjuha raciste, homofobike ose ksenofobike, është e lirë, gjuha e disa grupeve në shoqëri është e asfiksuar. E drejtë e secilit është të dëgjohet, të flasë dhe të marrë pjesë në jetën politike, artistike dhe jetën shoqërore, e cila është pjesë përbërëse e realizimit dhe gëzimit të barazisë. Kur njerëzve u mohohen pjesëmarrja publike dhe të shprehurit, çështjet e tyre, përvojat dhe kujdesi bëhen të padukshme dhe ata bëhen më vulnerabilë ndaj jotolerancës, paragjyqimit dhe marginalizimit. E gjithë kjo vë në dukje se standardet e rregullimit të lejueshëm kushtetues të gjuhës urrejtëse duhet të përshtaten me parimet fundamentale, të cilat i tejkalojnë kufijtë gjeografikë, kulturorë dhe historikë, dhe në të njëjtën kohë të mbeten mjaftueshëm të hapur për përshtatje në rrethana konkrete të shoqërisë. Këtu, parime fikse janë: transparenca ndaj pluralizimit dhe respektimit të nivelit më elementar të autonomisë, barazia, dinjiteti dhe reciprociteti.

Nga ana tjetër, variablat përfshijnë: historinë konkrete dhe natyrën e diskriminimit, statusin e grupit minoritar ose mazhoritar dhe fuqinë ose pafuqinë relative të atyre që emandojnë gjuhën urrjetëse dhe target-grupet e tyre në një shoqëri konkrete. Lufta me gjuhën urrjetëse duhet të bazohet në një qasje me tri nivele: zhvillimii politikave pozitive, mbrojtja përmes ligjeve/procedurave administrative dhe civile, si dhe parashikimi i sanksioneve penale. Secila nga këto është hallkë e pazëvendësueshme në përpjekjet e shoqërisë për luftimin e gjuhës urrjetëse dhe mbrojtjen e pluralizmit dhe diversitetit. Roli pozitiv i shtetit, në krijimin e mjedisit mbështetës për pluralizmin dhe diversitetin, është po aq i nevojshëm sa edhe qasja sanksionuese ose ndëshkuese e tij. Në mënyrë shtesë, jo të gjitha llojet e shprehjes në shtrirjen e “gjuhës urrjetëse” kërkojnë zbatim të dispozitave ndëshkuese-juridike. Një gjë e tillë do të mund të shpinte deri në kufizimin shumë të gjerë dhe të panevojshëm të shprehjes, të tipit: komente politike dhe debate, mospajtimet religjioze, komente ose kritika, si dhe shprehjet artistike (në rastin ‘Handyside’ kundër Britanisë së Madhe, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi që liria e shprehjes ka të bëjë edhe me informatat ose idetë, të cilat ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë”).

**Parimet ‘Camden’ për lirinë e shprehjes dhe barazisë janë udhërrëfyese,**<sup>16</sup> të dobishëm për politika dhe masa pozitive me të cilat garantohet liria e shprehjes dhe barazisë në shoqëri, siç janë:

**- Politikat dhe masat pozitive për realizimin e lirisë së shprehjes dhe barazisë në shoqëri,** të cilat nënkuptojnë ekzistimin e kornizës gjithëpërfshirëse juridike, e cila e mbron lirinë e shprehjes, legjislacionin antidiskriminues dhe

---

<sup>16</sup>The Camden Principles on Freedom of Expression and Equality, April, 2009

implementimine tyre, ndërtimin e njohurive institucionale dhe fushatat informative. Segmenteshumë me rëndësi janë edhe sfera civile dhe mediat. Kapaciteti i tyre për sensibilizimin e gjuhësurrejtëse, në të gjitha llojet e tij, duhet të zhvillohetpërmes dispozitave në kodin etik të gazetarëve, programet aksionaretë sindikatave të tyre dhe në kanalet e tyre të paraqesë temë të përhershme tëhapur për këtë çështje. Përkatësisht, kjo e fundit mund të quhet monitorim intern gjendjes në lidhje me gjuhën urrejtëse. Fusha që është me ndikim tëjashtëzakonshëm është arsimiti, andaj programet dhe kurrikulat më të sofistikuara duhet të zhvillohen në arsimin e lartë. Por, ato programe duhet të vendosen në të gjitha nivelet, nga kopshtet parashkollore deri në arsimin e lartë. Krugët e intervenimit, në të gjitha këto projekte, duhet të kenë një linjë kryesore: njohjen e kulturës së tjetrit dhe përpjekjen përkuptimin e saj si mënyrë për pasurimin e kulturës personale.

- **Procedurat civile dhe administrative**,janë gjithashtu instrumente të rëndësishme,të cilat u sigurojnë transparencë dhe theksin e vënë mbi grupet vulnerabletë pafavorizuara të shoqërisë. Ato viktimave u mundësojnë të kërkojnëkompensim/zhdëmtim, pavarësisht se duhet të jenë të arritshme bashkë me mekanizmate tjerë për mbështetjen e viktimave (për shembull ndihmë juridike përviktimat, e drejta e shoqatave civile që t'i përfaqësojnë viktimat etj.)

- **Sanksionet penale**,duhet të aplikohen në rastet e nxitjes së urrejtjes. Megjithatë,shtrirja e nocionit “nxitje” nuk është përcaktuar në mënyrë precize dhenë masë të madhe varet nga qasja juridike dhe gjyqësore e vendeve të caktuara.Disa elemente, të cekura në parimet ‘Camden’ për lirinë e shprehjes dhe

barazisë (shih veçanërisht në parimin 12<sup>17</sup> janë kryesore për ta kuptuar dhe përkufizuar “nxitjen”: përkufizimi i nocioneve (urrejtje, armiqësi, përfaqësim, nxitje), pranimi se nuk ekzistojnë baza të absoluara dhe serioze të veprës. Vlerësimi i “seriozitetit” të veprës (ose përcaktimit të asaj nëse ekziston nxitja ose jo) nga ana tjetër e përfshin hulumtimin e qëllimit të folësit, të nxisë diskriminim, armiqësiose dhunë; përmbajtjes së shprehjes, në kuptimin që veprimi/aksioni i përfaqësuar, shtrirja e shprehjes – në kuptimin e pozicionit të folësit dhe publikut, debat publik kundrejt bisedave private; rrezikut të pranishëm ose të drejtpërdrejtë – në kuptimin e kornizës kohore për paraqitjen e diskriminimit, armiqësisëose dhunës së përfaqësuar; besueshmërisë së diskriminimit, armiqësisë osedhunës si pasojë e shprehjes dhe konteksti i shprehjes në aspektin e kontekstit më të gjerë shoqëror të shprehjes.

#### **4.1. Studimet për ngacmimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi**

Argen Bright dhe Edgell<sup>18</sup> identifikuan katër lloje të veçanta të ngacmimeve. Sipas tyre, ekziston ngacmimi fizik, në formën e gjuajtjeve dhe goditjeve, ngacmimi verbal përfshin përdorimin e fjalëve që lëndojnë të tjerët, të tilla si ofendimet, komentet raciste, thirrja e emrit në mënyrë të përsëritur dhe shqetësuese, apo ngacmimet e ashpra. Ngacmimi relacional që ka të bëjë me tendencën për të përjashtuar një individ nga një grup i caktuar

---

<sup>17</sup>The Camden Principles on Freedom of Expression and Equality, April, 2009 f 4.

<sup>18</sup>Bullying in Middle Schools: Prevention and Intervention, Milsom, Amy; Gallo, Laura L. Middle School Journal (J1), v37 n3 p12-19, janar 2006. <http://www.nmsa.org/Publications/MiddleSchoolJournal/tabid/435/Default.aspx>,

shoqëror, që zakonisht realizohet përmes kërcënimeve të njëpasnjëshme dhe së fundi bullying reaktiv, i cili përfshin atë formë të ngacmimit ku individi mund të jetë njëkohësisht edhe viktimë edhe ngacmues. Fëmijët që ngacmojnë të tjerët, ata që ngacmohen, si dhe ata që ngacmojnë dhe ngacmohen në të njëjtën kohë, ndajnë një numër të përbashkët karakteristikash dhe kanë tendencë të vuajnë pasoja negative afatgjata<sup>19</sup>.

Nansel dhe bashkëpunëtorët<sup>20</sup> gjithashtu kanë shqyrtuar edhe frekuencën e llojeve të ndryshme të ngacmimit, përshtatjen psiko-sociale të nxënësve që kanë ngacmuar dhe atyre që kanë qenë pre e ngacmimeve. Ngacmimet verbale ishin më të shpeshta për të dyja gjinitë, komente për pamjen e tyre, komente të natyrës seksuale dhe thashetheme të ndryshme. Interesante nga gjetjet e këtij studimi ishte se komente negative rreth racës apo fesë janë raportuar shumë rrallë. Përsa i përket përshtatjes psikologjike, u gjet korrelacion pozitiv midis sjelljes ngacmuese dhe përlëshjeve, përdorimit të alkoolit, pirjes së duhanit dhe aftësisë për t'u shoqëruar (për të bërë miq). Arritjet akademike dhe perceptimet për shkollën, si një ambient me klimë negative, u asociuan shumë nga nxënësit që ishin pre e këtyre ngacmimeve. Vetmia gjithashtu ishte e lidhur pozitivisht me këto ngacmime.

Edhe vendet e Evropës në studime të ndryshme e kanë ekzaminuar dukurinë e ngacmimeve në mes të moshatarëve, duke i dhënë rëndësinë e duhur kësaj çështje. Në një studim të bërë

---

<sup>19</sup> School bullying Alana James PhD Researcher (Goldsmiths, University of London, NSPCC) February 2010, f. 24.

[http://iamnotscared.pixel-online.org/data/database/publications/384\\_NSPPCC%20Briefing.pdf](http://iamnotscared.pixel-online.org/data/database/publications/384_NSPPCC%20Briefing.pdf)

<sup>20</sup> Bullying Behaviors Among US Youth: Prevalence and Association with Psychosocial Adjustment, Nansel, 2001.

<http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC2435211>, janar 2016.



nga Rivers, Noters, Poteat dhe Ashurst<sup>21</sup>, në Mbretërinë e Bashkuar, u provua të identifikohej pasojat mentale që sjell bullying/apo ngacmimi në këtë rast në shkolla për nxënësit që janë dëshmitarë të rasteve të tilla. Në këtë studim morën pjesë 2002 nxënës, mosha e të cilëve varionte nga 12 deri në 16 vjeç. Nxënësit ishin pjesëtarë të 14 shkollave të ndryshme. Të dhënat në këtë studim u morën përmes anketave, duke përdorur pyetësorë që përfshinte pyetje në lidhje me ngacmimet që ndodhin në shkollë. Gjetjet e këtij studimi treguan se edhe në rastet kur nxënësit nuk janë viktima direkte të ngacmimit fizik ose psikik në shkollë, por janë dëshmitarë të rasteve të tilla, kjo mund të na dërgojë deri në dëmtime të jetës emocionale dhe mentale të tyre.

Studiuesit Fisher, Moffitt, Houts, Belsky dhe Caspi<sup>22</sup>, në një studim të tyre, poashtu të realizuar në Mbretërinë e Bashkuar, testuan nëse shpeshësia e rasteve të ngacmimeve psikike ose fizike të nxënësit nga nxënësit e tjerë mund të bëjë që rastet kur nxënësit provojnë të lëndojnë vetveten të jenë më të larta. Në këtë studim morën pjesë 2232 fëmijë, të cilët ishin të moshave 5, 7, 10 dhe 12-vjeçare. Rezultatet treguan se 2141 prej tyre kishin provuar të lëndonin veten dhe më shumë se gjysma e kishin bërë këtë si pasojë e ngacmimeve fizike dhe psikike që kishin

---

<sup>21</sup> Observing Bullying at School: The Mental Health Implications of Witness Status, School Psychology Quarterly © 2009 American Psychological Association 2009, Vol. 24, No. 4, 211–223, Ian Rivers Brunel University V. Paul Poteat Boston College Nathalie Noret York St. John University Nigel Ashurst Kent and Medway NHS and Social Care Partnership Trust, <https://www.apa.org/pubs/journals/releases/spq-24-4-211.pdf>

<sup>22</sup> Bullying victimisation and risk of self harm in early adolescence: longitudinal cohort study.

Fisher HL, Moffitt TE, Houts RM, Belsky DW, Arseneault L, Caspi A, 2012 <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/22539176>

përjetuar. Ky studim vërtetoi korrelacionin në mes të rasteve të ngacmimit fizik ose psikik të nxënësit nga bashkëmoshatarët e tyre, me tendencën për të kryer sjellje vetëlënduese.

Mbrojta nga diskriminimi është një e drejtë që rregullohet edhe me mjaft akte ndërkombëtare, duke filluar nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, si një akt ndërkombëtar deklarativ, dhe duke vazhduar me akte rajonale<sup>23</sup>, si: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe akte të BE-së që rregullojnë këtë të drejtë brenda këtij bashkimi.

Të gjitha direktivat e BE-së e ndalojnë këtë formë diskriminimi. Kjo ndodh kryesisht në ofrimin e shërbimeve në njësi tregtie apo klube nate, ku ndalohet hyrja për individë apo grupe, për një ndër shkaqet e diskriminimit, udhëzime për të mos u shitur apo dhënë me qira shtëpitë anëtarëve të minoriteteve, apo udhëzime për agjencitë e punësimit që të mos adresojnë punëkërkues mbi një moshë të caktuar.<sup>24</sup>

*1. Ngacmimi dhe udhëzimi për diskriminim sipas direktivave të BE-së për mbrojtjen nga diskriminimi.*

Ndalimi i ngacmimit dhe ndalimi i udhëzimit për diskriminim si pjesë e Ligjit Evropian për mbrojtjen nga diskriminimi janë zhvillime relativisht të reja, që u prezantuan për të krijuar më shumë mbrojtje.<sup>25</sup> Ngacmimi është një lloj specifik i diskriminimit

---

<sup>23</sup> BOOKMARKS -A MANUAL FOR COMBATING HATE SPEECH ONLINE THROUGH HUMAN RIGHTS EDUCATION B, Written and edited by Ellie Keen, Mara Georgescu Final editing Rui Gomes, Printed in Hungary ISBN 978-92-871-7840-4 © Council of Europe, 2014, f. 31.

<sup>24</sup> Handbook on European non-discrimination law, European Union Agency for Fundamental Rights, 2010. Council of Europe, 2010. The manuscript was finalised in July 2010, f.31.

<sup>25</sup> Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore, Prof. Dr. Arta MANDRO-BALILI, Tiranë, 2014, f.25

sipas direktivave të BE-së për mbrojtjen nga diskriminimi.<sup>26</sup> Më parë është trajtuar si manifestim i veçantë i diskriminimit të drejtpërdrejtë.

*Në përputhje me direktivat për mbrojtjen nga diskriminimi, ngacmimi do të konsiderohet si diskriminim kur:*

- *Ndodh një sjellje e padëshiruar e lidhur me një shkak të mbrojtur;*
- *Me synimin ose pasojën e dhunimit të dinjitetit të një personi;*
- *Dhe/ose duke krijuar një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fyes.*

Në përputhje me këtë përkufizim, nuk ka nevojë që një krahasues të provojë ngacmimin. Kjo në të vërtetë reflekton faktin se ngacmimi në vetvete është i gabuar për shkak të formës që merr (abuzim verbal, joverbal ose fizik) dhe efektit të mundshëm që mund të ketë (dhunimi i dinjitetit njerëzor).

Shumica e udhëzuesve lidhur me ngacmimin në nivelin e BE-së rrjedh nga Deklarata e Këshillit e 19 dhjetorit 1991 për zbatimin e rekomandimit të Komisionit për mbrojtjen e dinjitetit të grave dhe burrave në punë, duke përfshirë Kodin e Praktikave për Luftën kundër Ngacmimit.<sup>27</sup>

---

<sup>26</sup>BOOKMARS -A MANUAL FOR COMBATING HATE SPEECH ONLINE THROUGH HUMAN RIGHTS EDUCATION B, Written and edited by Ellie Keen, Mara Georgescu Final editing Rui Gomes, Printed in Hungary ISBN 978-92-871-7840-4 © Council of Europe, 2014, f.157.

<sup>27</sup>Handbook on European non-discrimination law, European Union Agency for Fundamental Rights, 2010. Council of Europe, 2010. The manuscript was finalised in July 2010, f.35.

## 4.2. Ngacmimi dhe udhëzimi sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Megjithëse KEDNJ-ja nuk e ndalon specifikisht ngacmimin ose udhëzimin për diskriminim, ajo përmban disa të drejta të veçanta që lidhen me të njëjtën fushë. Pra, ngacmimi mund të përfshihet në të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare të mbrojtur nga neni 8 i KEDNJ-së, ose e drejta për të mos u trajtuar në mënyrë degraduese ose çnjerëzore, sipas nenit 3, ndërsa Udhëzimi për diskriminim mund të përfshihet në nene të tjera, të tilla si liria e besimit ose tubimit, sipas nenit 9 ose 11, në varësi të kontekstit. Në rastet kur këto akte demonstrojnë motive diskriminuese, GJEDNJ-ja do të shqyrtojë pretendimet për shkelje të neneve përkatëse në lidhje me nenin 14, i cili ndalon diskriminimin. Më poshtë vijon një për zgjedhje e shembujve që demonstrojnë raste me fakte të ngjashme si ato të diskutuara më lart, të para në kontekstin e KEDNJ-së.

*Shembulli: Në çështjen Bączkowski dhe të tjerët kundër Polonisë (Bączkowski and others v. Poland), kryetari i bashkisë së Varshavës bëri deklaratat publike me natyrë homofobike, ku thoshte se do të refuzonte lejimin e një marshimi për rritjen e ndërgjegjësimit për diskriminimin për shkak të orientimit seksual.<sup>28</sup> Kur vendimi ishte përpara organit administrativ përkatës, leja u refuzua për arsye të tjera, të tilla si nevoja për parandalimin e përplasjeve ndërmjet demonstruesve. GJEDNJ-ja vendosi se deklaratat e kryetarit të bashkisë mund të kishin ndikuar vendimin e autoriteteve përkatëse dhe se vendimi u bazua tek orientimi seksual dhe kështu përbënte një shkelje të së drejtës*

<sup>28</sup>GJEDNJ, Bączkowski dhe të tjerët kundër Polonisë (Nr. 1543/06), 3 maj 2007 (ECtHR, Bączkowski and others v. Poland (No. 1543/06), 3 May 2007).

*për tubim të lirë në lidhje me të drejtën për të mos u diskriminuar.*

*Shembulli: Në çështjen ‘Paraskeva Todorova’, kundër Bullgarisë (Paraskeva Todorova v. Bulgaria),<sup>29</sup> gjykatat kombëtare, gjatë dënimit të një personi me origjinë rome, shprehimisht refuzuan rekomandimin e prokurorisë për dënim me kusht, duke deklaruar se te minoriteti rom ekzistonte kultura e pandëshkueshmërisë dhe duke nënkuptuar se personi në fjalë duhet të bëhej shembull. GJEDNJ-ja vendosi se kjo shkelte të drejtën e kërkuarit për një gjykim të drejtë e të paanshëm në lidhje me të drejtën për të mos u diskriminuar.*

*Pikat kryesore:*

- Diskriminimi përshkruan një situatë ku një individ është në disavantazh në një mënyrë të caktuar për shkak të një “karakteristike të mbrojtur”.
- Diskriminimi ka forma të ndryshme: diskriminim i drejtpërdrejtë, diskriminim i tërthortë, ngacmimi dhe pretendimi për diskriminim.
- Diskriminimi i drejtpërdrejtë karakterizohet nga trajtimi i diferencuar: duhet të dëshmohet se viktimja e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të posedimit të një karakteristike që përshihet në “shkakun e mbrojtur”.
- Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk e posedon karakteristikën e mbrojtur.

---

<sup>29</sup>Paraskeva Todorova vs. Bulgaria (Application no. 37193/07), Jurisdiction: European Court of Human Rights, 25 March 2009, <http://hudoc.echr.coe.int/tkp197/view.asp?item=1&portal=hbkm&action=html&highlight=37193/0>, prill, 2015.

- Mund të ndodhë që “shkaku i mbrojtur” të mos jetë arsyeja e saktë e trajtimit të diferencuar. Mjafton që arsyeja e vërtetë të jetë e shkëputur nga “shkaku i mbrojtur”.
- GJED-ja dhe gjykatat kombëtare kanë pranuar nocionin e diskriminimit për shkak të shoqërimit, ku një individ trajtohet në mënyrë më pak të favorshme për shkak të shoqërimit me një individ tjetër, i cili posedon “karakteristikën e mbrojtur”.
- Megjithëse trajtohet në mënyrë të veçantë nga e drejta e BE-së, ngacmimi është një manifestim i veçantë i diskriminimit të drejtpërdrejtë.
- Diskriminimi i tërthortë karakterizohet nga efektet ose impakti i diferencuar, duhet të demonstrohet se një grup vihet në disavantazh nga një vendim kur krahasohet me një grup krahasues.<sup>30</sup>
- Të provuarit e diskriminimit të tërthortë kërkon që një individ të japë prova se si grup ata që kanë karakteristika të mbrojtura i nënshtrohen ndikimit ose efekteve të diferencuara në krahasim me ata që nuk e kanë këtë karakteristikë.
- Me qëllim që çdokush t’i gëzojë në mënyrë të barabartë të drejtat, qeveritë, punëdhënësit dhe shërbyesit të duhet të marrin masa konkrete ose të posaçme për të përshtatur rregullat dhe praktikatat e tyre me ato me karakteristika të ndryshme.
- Termat “masa të posaçme” dhe “masa specifike” mund të përfshijnë ndreqjen e disavantazheve të pësuar në të shkuarën nga ata me një karakteristikë të mbrojtur. Aty ku kjo është proporcionale mund të përbëjë justifikim për diskriminim.

---

<sup>30</sup>Wojciech Sadurski, ‘Partnering with Strasbourg: Constitutionalisation of the European Court of Human Rights, the Accession of Central and East European States to the Council of Europe, and the Idea of Pilot Judgments’, 9 Human Rights Law Review (2009) f. 397.

Ngacmim konsiderohet çfarëdo sjellje e padëshirueshme mbi bazat e gjinisë, seksit dhe identitetit gjinor, që ka për qëllim apo pasojë shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fytes.<sup>31</sup>

### **4.3.Ngacmimet kibernetike**

Ngacmimet në shkolla kanë qenë dhe janë një dukuri shqetësuese për shumë vite e dekada.Studime të ndryshme sqarojnë për efektet negative, si në sferën fizike,psikologjike dhe sociale, në ato që janë pjesë e ngacmimeve si viktimë apo si ngacmues.Bota virtuale dhe globalizimi i internetit kanë bërë që ngacmimet në shkolla të evulojnë në një formë tjetër,më të frikshme e më ndikuese.Interneti nuk është vetëm mjet që ndihmon komunikimin, por përdoret edhe për të shkaktuar dëme të ndryshme.Me ndikimin që ka interneti ka ngritur shqetësime të mëdha për atë se sa do ta përkeqësojë klimën nëpër ambientet shkollore dhe me çfarë intensiteti do të dërgojë tensionin negativ në mes të moshatarëve.

Definimi i ngacmimeve virtuale - institucione dhe institute shkencëtarësh socialë, kanë bërë definime të ndryshme për ngacmimin në internet. Uebfaqja [www.cyberbullying.ca](http://www.cyberbullying.ca)<sup>32</sup>definin ngacmimin virtual si "përdorimi i teknologjisë së komunikimit dhe informacionit, të tilla si e-maili,telefonidhe mesazhe kërcënuese dhe sjellje virtuale armiqësore në mënyrë të përsëritur ndaj një individi, nga një individ ose grup tjetër(në shumicën e

---

<sup>31</sup> Ligji Nr. 05/L -020,PËR BARAZI GJINORE Kuvendi i Republikës së Kosovës; Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,28 maj 2015

<sup>32</sup> Shkumbin Gashi, <https://www.linkedin.com/pulse/ngacmimet-kibernetike-shkumbin-gashi>, Marrë nga interneti me datë 04.12.2015.

rasteve në mënyrë anonime).Merriam Webster e definojnë ngacmimin virtual si"postimi i mesazheve,fotografive dhe dëmeve të tjera në formë virtuale ndaj një personi nga një tjetër (ose grup). Departamenti i Shëndetit dhe Shërbimeve Humane në USA definojnë shkurt, por shumë qartë se "ngacmimi virtual është çdo ngacmim që përfshin përdorimin e teknologjisë elektronike".

- Mjetet potenciale për këtë lloj ngacmimi janë:
  - a) Kompjuteri;
  - b) Telefoni;
  - c) Tabletat e ndryshëm;
- Format e ngacmimit kategorizohen si më poshtë:
  - a) Mesazhe me përmbajtje urrejtëse;
  - b) Mesazhe ofenduese;
  - c) Shpërndarje fotografish denigruese;
  - d) Krijim profilesh të rrejshme.

Baza shkencore- Dueck,S.<sup>33</sup> citon rezultatet e një studimi nga Patchin dhe Hinduja, të realizuar me përafërsisht 1,400 adoleshentë, të cilët përdorin internetin.Tetëdhjetë përqind e tyre raportuan se ngacmimi virtual është prezent në interaksionet e tyre në internet.Poashtu është gjendur se 32% e meshkujve dhe 36% e femrave kanë raportuar për abuzim ‘online’.Nga këta nxënës,40% nuk ishin respektuar,12% ishinkërcënuar dhe 5% e tyre në fakt brengoseshin për sigurinë e tyre.<sup>34</sup>

Dallimet gjinore dhe ngacmimet virtuale- ngacmuesit virtualë, janë më shumë të gjinisë femërore sesa ata të gjinisë mashkullore

---

<sup>33</sup> Marr nga : Shkumbin Gashi, <https://www.linkedin.com/pulse/ngacmimet-kibernetike-shkumbin-gashi>

<sup>34</sup> Shkumbin Gashi, <https://www.linkedin.com/pulse/ngacmimet-kibernetike-shkumbin-gashi>, Marrë nga interneti me datë 04.12.2015.f.2



<sup>35</sup> Përafërsisht 60% e viktimave të ngacmimeve virtuale janë femra, ku 52% e ngacmuesve janë meshkuj. Shumica e këtyre viktimave, por edhe atyre që gjenden pranë tyre nuk i raportojnë incidentet tek të rriturit Li, Q.2007. Sipas të njëjtit burim, sa i përket raportimit, ka dallime gjinore, ku femrat më shumë se meshkujt kanë gjasa që t'i tregojnë dikujtjetër për ngacmimin potencial<sup>36</sup>.

- Pasojat e ngacmimeve virtuale;
  - Depresion;
  - Ankth;
  - Tërheqje;
  - Humbje e motivimit;
  - Largim nga jeta sociale;
  - Vetëbesim të ulët;
  - Probleme fizike;
  - Mendime vetëgjyquese;
  - Largim nga shkolla;
  - Mendime vetëlënduese<sup>37</sup>.

**Shenjat referuese-** Sipas [www.nobullying.com](http://www.nobullying.com) një fëmijë ka gjasa të jetë viktimë e ngacmimit virtual nëse:

- Shqetësohet kur dikush i dërgon një mesazh në internet ose telefon;
- Fillon të mbajë sekret aktivitetin e tij digjital;
- Fillon të tërhiqet nga familja dhe shokët/shoqet;

---

<sup>35</sup> Shkumbin Gashi, <https://www.linkedin.com/pulse/ngacmimet-kibernetike-shkumbin-gashi> (Ybarra, M.L. & Mitchell, J.K. 2004).

<sup>36</sup> Po aty, f.5

<sup>37</sup> Feinberg, T., & Robey, N. (2008). Cyberbullying. *Principal Leadership*, 9, 10–14. Empowering Students: Using Data to Transform a Bullying Prevention and Intervention Program, Anita Young, Ph.D., is the secondary school counseling specialist in Fairfax County, f 24

- Nuk merr pjesë në aktivitetet grupore;
- Shmangshkollën dhe aktivitetet përkatëse;
- Ka ndryshim drastik në disponim, gjumë dhe ushqim;
- Fillon t'i shmanget përdorimit të telefonit ose kompjuterit;
- Bëhet nervoz kur mesazhe të reja arrijnë;
- Fillon të bëjë sjellje vetëlënduese.

**Shenjat dalluese** se fëmija është ngacmues në internet janë:

- Inkurajon të tjerët të ngacmojnë;
- Është shumë agresiv ndaj të gjithëve;
- Qortohet dhe dërgohet në zyrën e drejtorit vazhdimisht;
- Dënohet shpesh;
- Fillon të ketë nëpër duar para ose gjëra të tjerëve;
- Nuk merr përgjegjësi për asgjë, duke përfshirë këtu edhe sjelljet e tij;
- Është shumë i brengosur për popullaritetin e tij/saj

**Si mund të ndihmojmë:** Si prindër dhe si komunitet duhet të përkujdesemi që t'u ofrojmë siguri e mbështetje të tjerëve rreth nesh, me theks të veçantë fëmijëve për shkak të natyrës së interaksioneve të tyre. Nëse vëreni se vëllai, motra, shoku ose shoqja juaj po ngacmohen, hapi i parë që duhet të ndërmerri është që me diskutoni për zgjidhjet e mundshme të situatës në fjalë. Sigurojeni personin që keni pranë se nuk është faji i tij/saj për këtë që po i ndodh.

Pasi që të kuptoni situatën, hapat që duhet të ndërmerri që të ndaloni ngacmimin virtual kundrejt dikujt rreth jush, por edhe ndaj vetë jush, janë:

**Komuniteti shkollor:** Bëjani të ditur shkollës se nxënësit nga po i njëjti ambient kanë filluar që të bëjnë ngacmime virtuale ndaj dikujt që ju e njihni ose ndaj jush. Në të dyja rastet merreni me

vete dikë që është i rritur dhe e kuptonisituatën mirë.Së bashku me shkollën diskutoni si të parandaloni akte të tilla në të ardhmen dhe çfarë do të ndodhë me ngacmuesit nëse janë të identifikuar.

**Dokumentimi:**Së bashku me personin që është viktimë ngacmimesh ose edhe vetëm kur ngacmimi ndodh ndaj jush dokumentoni të gjitha incidentet, duke përfshirë printimin e mesazheve,fotografimin e tyre dhe shkrimin e incidenteve në një fletore.Ky dokumentim do të ndihmojë kur ju të kërkoni ndihmë nga shkolla ose autoritetet e tjera.

**Injorimi:**Bllokojeni ngacmuesin nga rrjetet tuaja sociale,gjithashtu bllokoni numrin e telefonit të atij fëmije, në mënyrë që të mos dërgojë mesazhe të tjera.

**Qasja:**Derisa situata të vihet nën kontroll,mos hyni në internet ose mos e përdorni telefonin. Të njëjtën procedurë kërkoni nga shoku/shoqja juaj nëse ata janë viktimë ngacmimit.Kjo do ta zvogëlojë qasjen e ngacmuesit dhe do t'iparandalojë ndjenjat negative, si depresioni etj.

**Ndihmë:**Flisni me organizata të ndryshme që të ofrojnë ndihmë.Ka grupe të ndryshme që mund të ndihmojnë për tejkalimin e situatës dhe ofrojnë mbështetje emocionale.Këto grupe gjithashtu mund të ndihmojnë në gjetjen e një zgjidhje, se si të ndalohet së bashku ngacmimi virtual.

**Gjendja në Kosovë-**Sipas sociologëve,edhe në Kosovërrjetet sociale po keqpërdoren në nxitjen e gjuhës urrejtëse.

Rrjetet sociale si 'Facebooku' dhe 'Twitter', por edhe faqet e ndryshme të internetit, kohët e fundit në Kosovë kanë qenë të mbushura me komente dhe deklarime që kanë nxitur urrejtje

politike, ndërftare e ndërëtnike. Në faqen ‘online’ të “Radio Evropa e Lirë” thuhet se sociologët dhe psikologët konsiderojnë se kjo dukuri duhet të ndalet, pasi që, sipas tyre, kjo gjë mund të marrë përmasa shqetësuese. Për këtë arsye, “Radio Evropa e Lirë” i është drejtuar profesorit të psikologjisë në Fakultetin e Filozofisë, Mytafer Haskuka<sup>38</sup>. Ai thotë se kohët e fundit grupe të caktuara kanë filluar që rrjetet sociale t’i përdorin për qëllime të tyre, ku qartë në profile vërehet nxitja e urrejtjes. Haskuka thotë se ky fenomen në një farë mase mund të merret si shqetësim dhe konsideron që organet e sigurisë duhet të ndërmarrin masa.



Me Kodin Penal të Kosovës, në nenin 147<sup>39</sup>, mes tjerash, thuhet: Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo

<sup>38</sup> <http://www.evropaelire.org/a/26600417.html>, Marrë nga interneti ne prill 2015.

<sup>39</sup> GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 19 / 13 KORRIK 2012, PRISHTINË KODI NR. 04/L-082, KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

grupe të tjera të tilla që jetojnë në Republikën e Kosovës, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet. “Radio Evropa e Lirë” ka cituar edhe sociologun Artan Muhaxhiri <sup>40</sup>, ligjërues në Fakultetin e Filozofisë, i cili tregon se kohët e fundit gjuha urrejtëse është vërejtur në rrjetet sociale. Ai thekson se rrjetet sociale po konsiderohen shumë të shpejta në përhapjen e lajmeve, ndaj grupe të caktuar janë duke bërë propaganda të ndryshme që shpesh mund të hasësh edhe në ato të gjuhës urrejtëse. “Rrjetet sociale janë krijuar për të dhënë informacione të shpejta, por në rastin e Kosovës dhe në disa vende të tjera, rrjetet sociale po keqpërdoren”, thotë për “Radion Evropa e Lirë” profesori tjetër i sociologjisë, Fadil Maloku.<sup>41</sup>

**Rastet në Kosovë:**Janë të shumta, si rrjedhojë e përdorimit të gjuhës urrejtëse ‘online’ apo ‘offline’, nga komente, fotografi,mesazhe ofenduese dhe deri tek konfliktet verbale ose fizike e në disa raste kanë përfunduar edhe tragjikisht, si p.sh. një therje me thikë mes filloristëve në Prizren, 30 mars 2015 - 16:04. Rreth orës 09:20, policia në Prizren ka pranuar një informatë, e cila bënte me dije se një i mitur ndodhet i plagosur në emergjencën e spitalit rajonal.Një patrullë ka shkuar në spital dhe ka pyetur për rastin dhe, siç mësohet më vonë, dy të rinj, shokë klase, nxënës të shkollës fillore “Fadil Hisari” në Prizren, kishin pasur një mosmarrëveshje në “Facebook”.

---

<sup>40</sup> <http://www.evropaelire.org/a/26600417.html>, Marrë nga interneti neprill 2015

<sup>41</sup> Marrë ne internet më 08.04.2015 nga:  
[http://www.respublica.al/artikuj/2014/09/23/sociologët\\_thonë\\_se\\_rrjetet\\_sociale\\_po\\_keqpërdoren\\_në\\_nxitjen\\_e\\_urrejtjes](http://www.respublica.al/artikuj/2014/09/23/sociologët_thonë_se_rrjetet_sociale_po_keqpërdoren_në_nxitjen_e_urrejtjes).

“Nxënësit, pasi nuk kanë mundur t’i zgjidhin mosmarrëveshjet, ka plasur sherri mes tyre,që ka eskaluar në dhunë fizike dhe përdorimin e mjetit të mprehtë, me të cilin i dyshuari i ka shkakuar dy plagë në regjionin e shpinës së viktimës dhe dy të tjera në duar dhe një gërvishtje në faqe”, njofton Policia e Kosovës, raporton Koha.net<sup>42</sup>



Krimet kibernetike në Kosovë janë në rritje<sup>43</sup>. Policia e Kosovës gjatë këtij viti ka arritur që të arrestojë 7 persona, të cilët dyshohet se kanë keqpërdorur internetin, duke kryer sulme të ndryshme kibernetike.

Shefi i sektorit për hetimin e krimeve kibernetike në Policinë e Kosovës,në një konferencë të mbajtur në Prishtinë për krimet kibernetike, tha se dukuria e krimeve kibernetike në Kosovë është rritje.

---

<sup>42</sup> <http://koha.net/?id=3&l=50848> , marrë nga interneti datë, 08.04.2015, <https://youtu.be/yYpdAsivUE4>,

<sup>43</sup> <http://www.evropaelire.org/content/article/26749258.html> ,Prezantim nga shefi i sektorit për hetimin e krimeve kibernetike në Policinë e Kosovës, e mërkurë, dhjetor 02, 2015, Kosova, 09:30.Marrë nga interneti ne shkurt 2016

*“Gjatë periudhës janar- nëntor janë paraqitur 20 raste, çka do të thotë se ende nuk ka përfunduar viti dhe kjo tashmë është një indikator se kjo dukuri është në rritje. Tetë persona janë arrestuar në vitin 2012, njëmbëdhjetë në vitin 2013 dhe shtatë në vitin 2014. Në bazë të këtyre statistikave, duhet të përgatitemi mirë, sepse trendi i këtij llojit të krimeve është në rritje”.*

Sipas informatave dhe dëshmimeve që ka Policia e Kosovës, rrjetet sociale në Kosovë janë duke u keqpërdorur në masë të madhe.

*“Në rastet që raportohen në stacionet policore dominojnë keqpërdorimet e identitetit ose hapja e profileve të rrejshme me përmbajtje të papërshtatshme. Pastaj ka raste të shantazheve, ngacmimeve, publikimeve të paautorizuara dhe të tjera. Në këto raste më së shumti janë të përfshirë persona të moshës se re, por edhe të mitur”.*<sup>44</sup>

Poashtu, sipas një hulumtimi që e ka bërë Qendra për Trajnime dhe Studime Gjimore, mbi ”Njohuritë lidhur me Keqpërdorimin me Teknologji të Informimit dhe të Komunikimit”, është thënë se të rinjtë sot nuk i kushtojnë rëndësi të dhënave të tyre personale dhe si pasojë mund të ketë edhe sulme e ngacmime të ndryshme.

Krimi kibernetik është një veprim kriminal që zhvillohet në rrjetin e komunikimit, duke keqpërdorur sistemin dhe të dhënat kompjuterike.<sup>45</sup>

**Interneti, rreziku që u vjen papritur fëmijëve:** Një fotografi edy vajzave të mitura, e realizuar në një nga pishinat në vend, ishte publikuar në internet nga njëra prej këtyre vajzave. Ato nuk e kishin menduar se kjo fotografi do të keqpërdorej nga një person i papërgjegjshëm, i cili kishte ndërhyrë në të nëpërmjet

---

<sup>44</sup> <http://www.evropaelire.org/content/article/26749258.html> ,Prezantim nga shefi e sektorit për hetimin e krimeve kibernetike në Policinë e Kosovës, e mërkurë, dhjetor 02, 2015, Kosova, 09:30. Marrë nga interneti ne shkurt 2016

<sup>45</sup> <http://koha.net/?id=12&l=38052> ,Sa dinë të rinjtë e Kosovës për krimet kibernetike, 21 dhjetor 2014 - 17:53. Marrë nga interneti ne mars 2016.

programeve për përpunimin e fotografive, duke e publikuar në një sajt pornografik. Rrëfimin për keqpërdorimin e kësaj fotografie e tregoi drejtoresha në Qendrën për Studime të Avancuara, FIT, për të treguar se sa të rrezikuar janë të miturit nga keqpërdorimi i rrjeteve sociale. Por, kjo nuk është e keqja e vetme që fëmijëve po u ndodh nga interneti.

Ekspozimi ndaj materialeve të ndjeshme, siç janë ato pornografike dhe shikimi i pamjeve të dhunshme, janë edhe disa nga problemet serioze që fëmijët po i hasin gjatë përdorimit të internetit. “Sajbër dhuna, në radhë të parë, dhuna sidomos nëpërmjet rrjeteve sociale, shikimi i pamjeve të papërshtatshme, pornografia, pamje të dhunshme”, janë vetëm disa nga problemet. Këtë ajo e tha duke iu referuar një hulumtimi që FIT-it, të cilin e ka realizuar në bashkëpunim me organizatën “Save The Children”, rreth rreziqeve dhe sigurisë së përdorimit të internetit.





## 5. Relacionet e projektit me prioritetet zhvillimore të shtetit

**Sipas PSAK-ut**<sup>46</sup>, qëllimi i gjithmbarshëm i MASHT-it është që të zhvillojë dhe të integrojë plotësisht infrastrukturën e TIK-ut dhe përkrahjen e nevojshme teknike për implementimin dhe mbështetjen e qasjeve moderne pedagogjike. Me ndihmën e partnerëve zhvillimorë, tashmë janë shënuar përparime në zhvillimin e mëtejshëm të Sistemit për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA) dhe në sigurimin dhe përdorimin e kompjuterëve në arsim. MASHT-i ka për qëllim që të forcojë dhe të modernizojë infrastrukturën teknologjike në të gjitha shkollat dhe njësitë administrative.

**Sfida kryesore** e këtij nënsektori ka të bëjë me pranimin e teknologjisë së informimit e të komunikimit si mjet të inovacionit e të ndarjes së dijes. Me rëndësi është aplikimi dhe implementimi i të nxënies elektronik sinjle mjet efektiv i të nxënies. Janë identifikuar disa çështje dhe sfida që do të kenë ndikim afatgjatë në suksesin ose në dështimin e përpjekjeve për të filluar zbatimin e TIK-ut në arsim.

TIK-u në arsim ka potencial për të shtuar barazinë, për të siguruar qasjen e barabartë dhe për të zhvilluar kompetencat për të gjithë qytetarët. Një bazë fillestare teknologjike do të krijohet për të trajtuar çështjen e barazisë. Përdorimi i një hulumtimi për gatishmërinë e njerëzve për t'u kyçur në të nxënies elektronik do të ishte me rëndësi për të ndihmuar në sjelljen e vendimeve të

---

<sup>46</sup>Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT NË KOSOVË 2011-2016, f. 31.

informuara për trajtimin e çështjes së barazisë.

Caqet, sipas PSAK-ut<sup>47</sup> - Deri në vitin 2016 zhvillohen burimet njerëzore të afta për aplikimin e TIK-ut:

- Burime njerëzore të afta për zbatimin e TIK-ut në kategoritë përkatëse;
- Zhvillohet vlerësimi i bazës teknologjike për të trajtuar çështjen e barazisë;
- Mësimdhënës të përkushtuar për krijimin dhe zbatimin e përmbajtjeve elektronike;
- Zhvillimi i njohurive dhe shkathtësive në TIK;
- Komunitet i organizuar i ekspertëve për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme që ndjekin trendët e rinj të TIK-ut.

**Sipas KKK-së<sup>48</sup>**, integrimi në epokën digjitale - shoqëria e dijes, gjeneron dhe zhvillohet gradu

alisht në një epokë të re digjitale/elektronike dhe mjaft sfiduese. Për t'u integruar me sukses në një ekonomi digjitale/elektronike, nxënësve u nevojiten kompetenca digjitale. Prandaj, krahas njohurive themelore të alfabetizimit, shkrim-leximit dhe numërimit, sistemi aktual i arsimit duhet të nënkuptojë e të përfillë vetëdijesimin dhe alfabetizimin digjital, në mënyrë që të arrijë shkallën e alfabetizimit të plotë funksional. Megjithatë, vetëm njohuritë dhe shkathtësitë digjitale nuk mjaftojnë për të krijuar personalitete komplekse për epokën digjitale, sepse forcën kryesore të botës digjitale e përbëjnë njerëzit dhe vlerat themelore që ata promovojnë.

---

<sup>47</sup>Po aty, fq.38

<sup>48</sup>Korniza e Kurrikulit të Kosovës ,Prishtinë 2011,f. 37.



## II. METODOLOGJIA

### 2.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij studimi ishte të identifikohen shprehjet dhe format e fyerjeve dhe gjuhës urrejtëse përmes internetit, 'online' dhe 'offline', **si dhe pasojat që shkaktohen nga përdorimi i fjalëve urrejtëse nga nxënësit në mediat sociale**, si rezultat i keqpërdorimit të mjeteve elektronike.

Të identifikohen pasojat që lindin nga përdorimi i gjuhës urrejtëse 'online', qoftë përmes komenteve, publikimit të fotografive, publikimit të incizimeve të ndryshme që mund të ndikojnë negativisht në jetën e të rinjve për opinionin publik

Ideja u nxit nga leximi i literaturës së autorëve të ndryshëm vendorë dhe të huaj nga fushata e KE-së nëpër vendet evropiane 'No Hate speech online', nga bisedat me kolegë, si dhe nga nevoja që kërkon koha për ngritjen e vetëdijes së nxënësve, prindërve, mësimitdhënësve dhe të tjerëve për gjuhën urrejtëse 'online', nivelin e dhunës dhe pasojat negative që mund të shkaktojnë keqpërdorimi i mjeteve elektronike tek nxënësit në shkollë.

Rritja e internetit dhe veçanërisht krijimi i platformave të reja të mediave dhe rrjeteve sociale kanë bërë një ndryshim drastik në mënyrën se si funksionojnë bota dhe shoqëritë tona. Ato sigurojnë mjete të fuqishme për aktivistët për ndarjen e informacionit, fushatës dhe rrjeteve, por ka edhe rreziqe dhe kërcënime për hapësirë 'online'; gjuha urrejtëse po bëhet gjithnjë e më e zakonshme, përdoruesit janë të diskriminuar dhe të viktimizuar në komunitetet 'online' dhe ka çështje të shumta të sigurisë dhe të mbrojtjes së të dhënave kur duhet përdorur mjete të tilla.

## **2.2. Problemi huluntues dhe arsytimi**

PROBLEMI gjuhës urrejtëse ONLINE-mundësi të reja, rreziqe të reja.

Mundësitë për ndërveprim njerëzor kanë shpërthyer me paraqitjen e internetit. Interneti na ka dhënë mundësinë, në teori, për të komunikuar me pothuajse çdo person tjetër në botë! Çdokush që ka qasje në internet është tani edhe botues dhe drejtues publik.

Kjo është një risi që bota e ndërveprimit 'online' ka ardhur edhe për të reflektuar dhe ushqyer mbrapa në shumë prej vështirësive që qeniet njerëzore kanë hasur historikisht në ekzistencën e tyre "reale". Jotoleranca dhe 'urrejtja' kanë qenë një tipar i shoqërisë njerëzore pothuajse që kur filloi koha e internetit. Një numër studimesh kanë parë një rritje në këto qëndrime gjatë viteve të fundit.

Interneti ka hapur mënyra të reja për t'u thënë gjërat dhe ai ka hapur shtigje të reja për të thënë nga shumë njerëz. Kufizimet, megjithatë, në atë që ne mund të themi 'online' janë shumë më pak se ato që ekzistojnë 'offline': ne mund të themi shumë gjëra në internet që ne nuk do të guxonim t'i themi ndonjëherë në publik në botën 'reale'.

Duke pasur parasysh mundësitë për përdorim të pakufishëm të internetit dhe faqeve të ndryshme nga të rinjtë tanë dhe fjalimin urrejtës që zakonisht bëhet përmes komenteve të ndryshme ofenduese, publikimin e fotografive dhe videove të incizuara nga vetë të rinjtë, po ashtu dhe pasojat që fillojnë nga ngacmimi, tallja, nënçmimi, deri tek dhuna që transferohet në shkollë, apo

edhe në komunitet, por në disa raste në vendin tonë edhe në pasoja vdekjeprurëse. Është më se e rëndësishme të hulumtohet, diskutohet dhe realizohet fushata që mund të kontribuojë dhe parandalojë një gjë të tillë në shkollat tona dhe në vendin tonë.

## 2.3. Objektivat e përgjithshme dhe të veçanta

### Objektivat e përgjithshme

Për të mundësuar aktorët në kontekste formale dhe joformale të arsimit, për të adresuar gjuhën urrejtëse tek njerëzit, ku përfshihen edhe komunitetet shkollore në fushatën jourejtëse:

- Të zhvillojnë aftësitë dhe motivimin për të rinjtë të njohin gjuhën urrejtëse në internet.
- Të rrisë ndërgjegjësimin e parimeve të të drejtave të njeriut për të promovuar një vizion të internetit, që reflekton **këto parime**:
- Të mbështesë edukimin për të drejtat e njeriut përmes qasjeve joformale të mësimin dhe për të zhvilluar frymë kritike në mesin e fëmijëve dhe të rinjve;
- Të fuqizojë ata që janë tashmë viktima të gjuhës urrejtëse në internet, ose i cili ka të ngjarë të bëhen viktima;
- Për të inkurajuar ndjeshmëri për grupe apo individë, të cilët mund të jenë shënjestër e gjuhës së urrejtëse në internet
- Për të thyer mitet dhe paragjykimet për disa nga objektivat më të zakonshme të gjuhës urrejtëse.

### Objektivat specifike

Projekti ka këto qëllime:

- Të rrisë ndërgjegjësimin e të rinjve dhe komunitetit të gjerë për ekzistimin e gjuhës urrejtëse në internet dhe rreziqet që paraqet për demokracinë dhe të rinjtë në mënyrë individuale, sepse

"Gjuha urrejtëse, e përcaktuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, mbulon të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjeraurrejtëse, të bazuara mbi intolerancën, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi dhe etnocentrizmi agresiv, diskriminimit dhe armiqësisë kundër pakicave, emigrantët dhe njerëzit me origjinë emigrante.

- Të promovojë në media dhe në internet.
- Për të mbështetur të rinjtë për të drejtat e njeriut, 'online' dhe 'offline';
- Për të ulur nivelet e pranimit të gjuhës urrejtëse në internet;
- Të identifikojë gjuhënurrejtëse në internet dhe të zhvillojnë mjetet për të luftuar atë;
- Të mbështesë dhe të tregojnë solidaritetin ndaj njerëzve dhe grupeve të synuara me gjuhën urrejtëse në internet.
- Të mbrojnë zhvillimin edhe me konsensus për instrumentet e politikës evropiane në luftimin e gjuhës urrejtëse në mediet sociale etj.

## **2.4. Metodat e hulumtimit**

Për qasje më objektive dhe më të besuar përdorëm këto metoda: *teorike* - për të nxjerrë të dhëna dhe hulumtime që i kanë bërë të tjerët për temën, *përshkruese* - për përshkrimin e gjendjes në terren, *shpjeguese* - për të paraqitur problemet dhe *analitike* -për prezantimin e gjetjeve gjatë hulumtimit, përdorëm të dy metodat, *sasiore* dhe *cilësore*.

### **2.4.1. Popullata dhe mostra**

Popullatën e përbëjnë nxënës të moshës 14-15-vjeçare dhe mësimdhënës të po kësaj moshe të caktuar. Kurse për mostër kemi përcaktuar hulumtimin të realizohet në pesë shkolla fillore të larta, me mësimdhënës dhe nxënës.

Gjithsej pyetësi u realizua me 177 nxënës dhe 97 mësimdhënës, në pesë shkolla.

#### **Pyetjet kryesore të hulumtimit ishin:**

1. A ekziston gjuha urrejtëse në internet (në çfarëdo forme, komente, publikime fyerje etj.) nga nxënësit e moshës 14/15 vjeçare?
2. A ndikon përdorimi i mjeteve elektronike në shtimin e gjuhës urrejtësenë shkollë, duke përfunduar në dhunë/ngacim psikik apo fizik?

#### **Pyetjet ndihmëse:**

1. Sa është i pranishëm ngacmimi psikik apo fizik shkaktuar nga përdorimi i mjeteve elektronike në shkollat tona?
2. Si po reflektohet ajo?

Mbledhja e të dhënave për hulumtimin u organizua në tri faza:

- Shqyrtimi i literaturës;
- Analizae raporteve dhe dokumenteve zyrtare lidhur me gjuhën urrejtëse dhe krimet kibernetike;
- Mbledhja e informatave paraprake;
- Anketimi me nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollës së mesme të lartë;



- Hartimi i raportit dhe prezantimi;
- Publikimi i raportit.

**Pjesëmarrësit:** Mësimdhënës dhe nxënës (mosha 14 dhe 15 vjeç)

Instrumentet që u përdoren:


- Pyetësori për mësimdhënës dhe
- Pyetësori për nxënës.

## **2.5. Rezultatet e hulumtimit dhe interpretimi i tyre**

Pyetësori u realizua në shkollë të mesme të ulëta, rezultatet e fituara u analizuan, u përpunuan dhe u krahasuan. Rezultatet u paraqiten në mënyrë statistikore dhe në grafike, në mënyrë që të shihet krahasimi i tyre.


### **2.5.1 Analiza e të dhënave të fituara nga pyetësori i nxënësve**

Hulumtimi u realizua në shkollë të mesme të larta në Kosovë, nëpërmjet shkollë fillore të mesme të larta, me gjithsej 177 nxënës. Nga rezultatet e fituara rezulton se në Kosovë interneti përdoret në masë jashtëzakonisht të madhe nga nxënësit dhe ka pasoja negative, sidomos në përdorimin e fjalëve/gjuhës urrejtëse në faqe të ndryshme sociale. Pyetësori përbëhej nga 13 pyetje me alternativa dhe është bërë analiza e tyre për secilën veç e veç.




Grafiku 1. Se sa ndikon koha e shfrytëzimit të internetit nga nxënësit dhe kontrollin që kanë prindërit që janë të angazhuar në punë dhe ata që prindërit e tyre janë të papunë kemi bërë dhe pyetjen A punojnë prindërit tuaj?

Nga pyetësorët që realizuam vërehet se përdorimi i internetit pa censurë më shumë përdoret nga fëmijët, prindërit e të cilëve punojnë dhe koha e tyre për këshillim/kontroll është më e pakët.




Grafiku 2. Si shfrytëzohet koha e lirë nga nxënësit në...?

Në bazë të rezultateve të fituara nga pyetja nr. 2, se ku e kalojnë kohën e lirë zakonisht fëmijët e moshës 14/15-vjeçare, del se 40% e tyre kohën e lirë e kalojnë duke përdorur internetin, ndërsa vetëm 7% e tyre në aktivitete sportive.




Grafiku 3. Sa orë qëndrojnë gjatë ditës zakonisht në kompjuterë /telefon (internet) medie sociale?

Edhe nga pyetja e tretë shohim se numri i fëmijëve që përdorin internetin është 85%, që bie në kundërshtim me pyetjen e dytë se ku ata e kalojnë kohën e lirë. D.m.th. shumica e nxënësve përdorin internetin, qoftë kompjuter/telefon.




Grafiku 4. Për çfarë interesohen më shumë kur janë pranë kompjuterit, kur e shfrytëzojnë internetin, mediet sociale. (telefon, ipad, PC)?

Nga të dhënat e fituara vërehet se shumica e nxënësve të moshës 14 dhe 15-vjeçare preferojnë rrjetet sociale kur përdorin kompjuter apo telefon 33.3% dhe 20.3% kalojnë kohën në forume ‘online’, që do të thotë se rreziku për gjuhënurrejtëse apo diskriminimit është mjaft eventual.




Grafiku 6. A ju ka ndodhur që t’ju dërgojë dikush sms/komente provokuese ose fyese?

Nëse kanë pranuar ndonjëherë sms/komente provokuese ose fyese, 49% nga të dhënat e fituara shohim se kanë marrë fyerje, ndërsa 32% ndonjëherë.




Grafiku 7. A ju ka ndodhur t'u dërgojë dikush mesazh/koment provokues ose fyese përmes internetit, si: ('Facebook', 'Instagram', apo e-mail, ose tjetër)?

Pas parasysh përdorimin e shumë të rrjeteve sociale, si 'Facebook', 'Instagram' apo e-mail, ose tjetër dhe marrjen e mesazheve/komenteve provokuese, ose fyese përmes internetit, përgjigjet janë shqetësuese, duke analizuar të dhënat me 68% të tyre se shumë shpesh u ka ndodhur të hasin në komente të tilla, fyerje.



Grafiku 8. Si ke reagoj ndaj mesazheve provokuese në telefon ose internet?

Mënyra se si kanë reagoj në raste të tilla, 48% të nxënësve përgjigjen se i injorojnë këto raste, ndërsa 31% përgjigjen po në mënyrë paqësore, ndërsa 13.50% u janë përgjigjur në të njëjtën mënyrë.




Grafiku 9. A ka pasur ndonjë konflikt si rezultat i mesazheve provokuese në internet?

Nëse kanë pasur konflikte si rrjedhojë e fyerjeve ‘online’ ose mesazheve provokuese, 37% nga përgjigjet thonë se po ka përfunduar me konflikte fizike, ndërsa 47% të tyre se konflikti ishte verbal me fyerje dhe ofendime të ndërsjella.


### **2.5.2. Analiza e të dhënave të fituara nga pyetësi i mësimitdhënësve**

Hulumtimi u realizua në shkolla të mesme të larta në Kosovë, me gjithsej 97 mësimitdhënës. Edhe nga rezultatet e fituara nga pyetësi i mësimitdhënësve shihet se gjuha urrejtëse ekziston ndërmjet nxënësve.




Grafiku 1. A i shfrytëzojnë nxënësit tuaj mediet sociale?

Nga të dhënat e fituara shohim se 74% të nxënësve shfrytëzojnë mediet sociale, ndërsa vetëm 26% përgjigjen se nuk i shfrytëzojnë mediet sociale.



Grafiku 2. A keni informata se ka ngacmime nga nxënësit përmes mjeteve digjitale?


Nëse mësimdhënësit janë në dijeni se ka ngacmime nga nxënësit në shkollë përmes mjeteve digjitale, popërgjigjen 68% e tyre, ndërsa 32%, se nuk ka ngacmime nga mjetet digjitale.



Grafiku 2. Nëse po, a janë raportuar këto raste te ju?









Grafiku 4. Cilat prej formave të mëposhtme negative sjellin mjetet elektronike tek nxënësit tuaj?

Në pyetjen se cilat prej formave të mëposhtme negative sjellin mjetet digjitale te nxënësit tuaj, 43% janë përgjigjur se janë mesazhet e padëshirueshme, 26% fyerjet nga shoqëria dhe 19% fotot dhe videot joedukative, ndërsa 13% kemi nga thirrjet telefonike të padëshirueshme.




Grafiku 5. A informohen prindërit për këto ngacmime?

Në raste të tilla a njoftohen prindërit nga ju, përgjigjet me po janë 74%, ndërsa me jo 26%.




Grafiku 6. Nëse po, kush i njofton prindërit për këto ngacmime?

Se kush i njofton prindërit del se 58% se njoftohen nga drejtorja e shkollës, 29% nga arsimtarët dhe vetëm 13% të rasteve nga vetë nxënësit, po ashtu kjo bie në kundërshtime me pyetjen se **kush i raporton ngacmimet e nxënësve përmes mjeteve digjitale dhe se kush i raporton ngacmimet e nxënësve përmes mjeteve digjitale përgjigjen 58% se raportohen nga shokët e tyre, vetëm 17% nga prindërit dhe 16% nga vetë nxënësit dhe vetëm 8% nga stafi i shkollës.**



Grafiku 7. A ofron shkolla trajnime, këshilla, apo informata nëpërmjet ndonjë lënde mësimore për të udhëzuar nxënësit për përdorimin e drejtë të medieve sociale?

42% e mësimdhënësve përgjigjen se nuk kanë fare njohuri nëse ofron shkolla trajnime apo këshilla, apo nëpërmjet ndonjë lënde mësimore për të udhëzuar nxënësit për përdorimin e drejtë të medieve sociale, 25% thonë se nganjëherë, 20% asnjëherë dhe 13% e tyre shpeshherë.



Grafiku 8. A keni marrë ndonjë iniciativë për të ndihmuar nxënësit e ngacmuar/fyer përmes mjeteve elektronike/medieve sociale?

Në pyetjen se nëse mësuesit kanë marrë ndonjë iniciativë për të ndihmuar nxënësit e ngacmuar/fyer përmes mjeteve digjitale/medieve sociale, përgjigjen 73% jo, ndërsa 27% përgjigjet i kemi se kanë marrë iniciativë.

### **III. KËSHILLA TË PËRGJITHSHME PËRINTERNETIN**

Nga shqyrtimi i literatures teorike dhe nga hulumtimi i realizuar ofrojm këto këshilla të përgjithshme që do ju ndihmojnë mësuesve, prindërve dhe nxënësve të informohen më shumë lidhur me pasojat dhe sfidat që përballen të rinjtë në botën virtuale. Ekziston një numër i madh i rreziqeve potenciale që rrezikojnë privatësinë dhe sigurinë e shfrytëzuesve të tij, veçanërisht për privatësinë dhe sigurinë e fëmijëve dhe tinxherëve dhe familjeve të tyre.

Fëmijët janë veçanërisht të ndjeshëm për shkak të çiltërsisë së tyre fëmijërore, naivitetit dhe mungesës së përvojës, por edhe të rriturit, sepse për një pjesë të madhe të tyre interneti paraqet një medium krejtësisht të ri dhe të panjohur. Prandaj, njohja e disa rregullave themelore për të pasur kujdes në internet çdokujt mund ti jenë të dobishme dhe t'u ndihmojnë ta mbrojnë vetveten, por edhe të afërmit e tyre.<sup>49</sup> Bota virtuale e internetit është bërë aq e madhe, duke ofruar informata dhe mundësi të pafundme për të mësuar dhe argëtuar. Përdorimi i internetit është bërë aq i lehtë sa ju mund të keni qasje nga kompjuteri, telefoni, apo aparatetë tjera kompjuterike. Këto aparate kompjuterike ju mundësojnë që fotografitë apo videot e çastit t'i postoni menjëherë në internet, duke i publikuar ato në faqe të ndryshme të internetit, si rrjetet sociale apotë tjera.

Publikimin e fotografive, videove, dhe informatave personale nganjëherë e bëjmë pa menduar mirë. Ndonjëherë ne ose miqtë

---

<sup>49</sup><http://bezbednonainternet.org.mk/content/view/13/40/lang.sq/> Maj, 2015.

tanë kanë publikuar gjëra që ne nuk dëshirojmë t'i publikojmë ato në internet dhe dëshirojmë menjëherë t'i heqim. Shumica e faqeve në internet ju mundësojnë të fshini gjërat që i keni postuar, por mos harroni se ato gjëra kanë qenë publike dhe dikush mund t'i ruajë ato dhe t'i publikojë prapë pa dëshirën tuaj.

Gjatë përdorimit të internetit, ju mund të takoni njerëz me synime të këqija që mund të përpiqen t'ju bindin që të postoni në internet informata ose fotografi personale që ju nuk dëshironi t'i publikoni, andaj gjithmonë refuzoni këto kërkesa që cenojnë privatësinë tuaj. Nëse ju ndiheni në presion për ndonjë gjë që dikush kërkon që ju të bëni gjatë bisedave në internet, apo në rrjetet sociale, ju mund ta bllokoni menjëherë atë person, duke mos lejuar t'ju bezdis më shumë.

Për fat të keq, në internet mund të takoni disa njerëz vërtet të çuditshëm, të cilët nuk janë miqësorë ose që kanë qëllime të këqija. Disa prej tyre përdorin internetin dhe disa prej tyre përdorin telefonat celularë, prandaj duhet të jeni shumë të kujdesshëm që të mos ballafaqoheni me persona të kësaj kategorie dhe në raste të tilla të njoftoni prindërit apo një të rritur në familjen tuaj.

### **3.1. Ngacmimi seksual – Sajnërdhuna (cyberbulling)**

Ngacmimi virtual përmes teknologjive, si telefonat celularë apo interneti, mund të dëmtojë dikë jo vetëm në shkollë, por edhe në shtëpi. Kjo ndodh pasi që si telefoni celular ashtu edhe interneti ofrojnë qasje 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë dhe personat e prirë për të bërë ngacmime përmes internetit mund ta bëjnë atë, duke e

bërë një person të caktuar të ndihet i mërzhitur ose i kërcënuar kudo që gjendet, në shkollë apo shtëpi.

Për të identifikuar personin që bën ngacmime përmes telefonit celular apo internetit, ndonjëherë mund të jetë e vështirë, pasi që ata njerëz mund të bllokojnë të dhënat e tyre personale dhe adresa e tyre elektronike mund të jetë anonime.

Natyra e këtij lloj ngacmimi mund të jetë shumë gjithëpërfshirëse, që nganjëherë shumë njerëz nuk e kuptojnë që janë pjesë e ndonjë ngacmimi. Andaj, asnjëherë mos participoni duke përcjellë tek personat e tjerë mesazhet që ju i merrni nga dikush që ka për qëllim të fyejë një person. Ndonjëherë kjo mund t'ju duket si një shaka, por kjo shaka mund të jetë shumë tronditëse për një person të përfshirë në këtë ngacmim.

Nëse jeni të shqetësuar se dikush është duke ju kërcënuar apo ngacmuar, qoftë në internet apo përmes telefonit celular, atëherë informoni një të rritur në familjen tuaj në mënyrë që t'ju ndihmojë për ta ndaluar atë person.

Gjithmonë respektoni njerëzit e tjerë dhe gjithmonë të jeni të vetëdijshëm për atë që merrni dhe dërgoni gjatë kohës që ju jeni në internet.

### **3.2. Rrjetet sociale**

Ka një numër të gjërave që duhet menduar para se të filloni të përdorni faqet e rrjeteve sociale. Kur hapni profilet tuaja në faqet e rrjeteve sociale, gjithmonë duhet të keni kujdes se çfarë informacioni përfshini në profilin tuaj. Mos harroni se ju nuk keni njohuri se kush janë shokët e shokut tuaj dhe ju nuk e dini se çfarë do të ndodhë me fotografitë e postuara në profilin tuaj ose me informatat tuaj personale si adresa elektronike, adresa e shtëpisë, ose numri i telefonit celular. Të jeni të vetëdijshëm se



informatat dhe fotografitë tuaja në profilin tuaj mund të shihen nga kushdo.<sup>50</sup> Pra, nëse ju nuk ndiheni rehat me këtë fakt, atëherë më mirë të mos i publikoni ato në profilin tuaj dhe mos t'i bëni publike. E njëjta gjë vlen edhe për shkrimet që mund t'i postoni në profilin tuaj, të cilat mund të shihen nga kushdo.

Nëse nuk do dëshironit që një shkrim apo koment të shihet nga prindërit, familjarët, apo ndonjë person i caktuar, më mirë mos e postoni atë. Gjithmonë duhet të keni kujdes në atë çka shkruani në rrjetet sociale, pasi që një temë mund të duket shumë normale për ju, por për disa njerëz të caktuar jo. Në raste të caktuara mund të ofendoni dike pa ndonjë qëllim.

Gjithashtu, duhet të keni kujdes kur pranoni shokë apo shoqe në rrjetet sociale. Nëse këta persona nuk janë të njohur për ju, mos i pranoni ata duke mos ju lejuar të kenë qasje në profilin tuaj dhe informata apo fotografitë tuaja personale. Njerëz të panjohur në rrjetet sociale mund të ju bezdisin, duke ju kërkuar të bisedoni me ta në internet, duke mos pasur informata nëse ata njerëz janë me të vërtetë ata që paraqiten në profilet e tyre. Të njëjtit mund të kërkojnë të takohen me ju apo t'ju marrin informata personale, gjë që nuk duhet lejuar.<sup>51</sup> Nëse ballafaqoheni me dukuri të këtij lloji, rekomandohet të njoftoni prindërit apo mbikëqyrësit tuaj dhe të merrni mendimin e tyre rreth kësaj çështje.

---

<sup>50</sup>Shih me gjerësisht ne <http://fit-ks.org/wp-content/uploads/2015/11/Guider-per-Prinder-all.pdf> , UDHËZUES I DETAJUAR PËR PRINDËR, KUJDESTARË DHE EDUKATORË/MËSIMDHËNËS PËR RRJETET SOCIALE, Botuar nga: Save the Children, Prishtine Tetor 2015.

<sup>51</sup>Shih me gjerësisht ne <http://bep-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Udhezues-per-Prinder-dhe-Edukator.pdf> , Siguria e Fëmijëve në Internet Udhëzues për prindër dhe edukatorë, Botuar nga: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), Prishtine, f.22

### **3.3. Postimi i fotografive dhe videove në internet**

Postimi i fotografive dhe videove në internet, si faqet e rrjeteve sociale dhe aplikacionet si dhomat e diskutimit (chat rooms) dhe mesazhe të menjëhershme (instant messenger – IM) janë mënyra tejet argëtuese, duke ndarë momente të ndryshme të jetës tuaj me miqtë dhe familjen tuaj, të cilët i keni si shokë në një rën nga këto faqe.

Por a janë gjithmonë ato fotografi apo video që duhet të ngarkohen në internet? A do dëshironit që ato fotografi t'i shohin prindërit tuaj? Ndoshta në disa raste ju mund t'i bëni prindërit tuaj të ndihen të turpëruar. Prandaj, para se të postoni ndonjë fotografi apo video në internet, bëni mirë të konsultoheni me prindërit tuaj nëse ato fotografi janë për t'u postuar. Në këtë mënyrë ju asnjëherë nuk do të lejoni veten të gjendeni në pozita të sikletshme, duke mos lejuar që fotografitë apo videot tuaja të keqpërdoren nga njerëz të ndryshëm në internet.

### **3.4. Telefoni celular**

Përdorimi i telefonit celular është një mënyrë tjetër dhe tejet argëtuese për të qëndruar në kontakt me miqtë dhe familjen tuaj, duke bërë lidhje telefonike direkte apo përmes mesazheve. Rekomandohet që numrin tuaj të telefonit celular ta kenë vetëm njerëzit që ju i njihni, në mënyrë që mos të merrni telefonata apo mesazhe nga njerëz të panjohur, të cilët mund t'ju shqetësojnë për gjëra të ndryshme. Nganjëherë mund të merrni mesazhe nga njerëz të panjohur me përmbajtje tronditëse për ju, por asnjëherë mos iu përgjigjeni këtyre mesazheve dhe menjëherë njoftoni prindërit apo mbikëqyrësin tuaj që ta parandalojnë këtë dukuri.

Në këto raste gjithmonë mbani në mend numrin, i cili ju dërgon mesazhe shqetësuese dhe në rast se ju bën thirrje asnjëherë mos e hapni telefonin.

Për të evituar këto situata, është mirë që asnjëherë të mos ua jepni numrin tuaj të telefonit njerëzve të cilët nuk i njihni. Kjo edukatë duhet të praktikohet edhe gjatë përdorimit të internetit, kur njerëzit e panjohur ju kërkojnë numrin e telefonit celular, asnjëherë mos ua jepni atë dhe asnjëherë mos u takoni me njerëz të panjohur që ju kërkojnë në internet apo përmes telefonit celular të takoheni me ta. Të mos harroni se ju nuk e njihni atë person dhe mund t'jubbëjë ndonjë të keqe nëse takoheni.

### **3.5. Lojërat në internet**

Kur luani një lojë, qoftë në internet apo të instaluar në kompjuterin tuaj, mund të përjetoni ndjesinë se patjetër duhet të fitoni apo kaloni në nivelin tjetër. Është me rëndësi të kuptojmë se kjo është vetëm një lojë, një mënyrë argëtimi që ndonjëherë fitojmë dhe ndonjëherë humbim. Nuk ka asgjë të keqe nëse humbni, nëse disa raste kur pësoni humbje vetëm se bëheni më të shkathët, pasi që keni filluar ta kuptoni strategjinë e lojës. Në këso raste, kur jeni duke lozur në internet, duhet të keni kujdes që kur jeni fitues apo humbës të mos e bezdisni apo fyeni dikë në internet që luan bashkë me ju.

Është mirë të përdorni një pseudonim apo shkurtesë të emrit tuaj kur ju jeni duke përdorur faqet e lojërave, në vend të emrit tuaj të vërtetë. Gjithmonë në rrjetin e lojërave ka njerëz nga e gjitha bota, për të cilët ju nuk keni informata se kush janë. Andaj, kujdesi juaj gjatë kohës në internet duhet të jetë në nivelin e duhur.

### **3.6. Dhomat e diskutimit**

Nëse jeni adhures i dhomave të diskutimit (chat rooms) për të biseduar me miqtë tuaj, gjithmonë përdorni një shkurtesë të emrit tuaj apo ndonjë nofkë tjetër që të mos identifikoheni saktësisht se kush jeni. Miqve apo njerëzve që i njihni mund t'ua tregoni shkurtesën e emrit tuaj që ata të ju identifikojnë se kush jeni ju, por këtë informatë mos ta bëni publike.

Mbrojtja e informatave personale është gjë shumë e rëndësishme që ju mos të ballafaqoheni me ndonjë dukuri negative gjatë komunikimit në internet që mund t'ju vijë nga njerëz të panjohur. Edhe atëherë kur ju merrni mesazhe nga persona të panjohur, asnjëherë mos iu përgjigjeni dhe mos hyni në bisedë me ta pasi që ai person i panjohur dëshiron të marrë informata personale tuajat dhe të dijë më shumë për ju, të cilit asnjëherë nuk ia dini motivin. Gjithmonë në këto lloje situatash është mirë t'i njoftoni prindërit që të merren me këtë çështje.<sup>52</sup>

### **3.7. Si pasojë e komunikimit në internet, rrjetet sociale vjen edhe deri te trafikimi i fëmijëve**

Në moshën tuaj, shumë nga ju mund të keni dëgjuar lidhur me “trafikimin e fëmijëve”, por sigurisht nuk keni arritur ta kuptoni se çka më saktësisht është trafikimi i fëmijëve. Si në gjithë botën, kjo dukuri ekziston edhe në vendin tonë, e cila kryhet nga persona të panjohur, por të cilët e bëjnë këtë gjë për përfitime

---

<sup>52</sup>Për më gjerësisht shih në <file:///C:/Users/User/Downloads/udh%C3%ABzuesi%203.pdf>, Udhëzues për prindër për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të fëmijëve në internet, Shkup, qershor 2015.

personale. Pjesë e kësaj dukurie në shumicën e rasteve janë fëmijët dhe adoleshentët e të dy gjinive.

***Çka është trafikimi i fëmijëve dhe cilat janë këshillat që do t'ju ndihmojnë të rrini gjithmonë larg këtij fenomeni?***

Trafikimi i qenies njerëzore është rrëmbimi apo lëvizja e një fëmije apo adoleshenti, me qëllim të shfrytëzimit për përfitime personale. Trafikimi i qenieve njerëzore kryhet kryesisht nga rrjetet kriminele, të cilat kanë qëllim të vetëm përfitimin material. Këto rrjete kriminele targetojnë kryesisht fëmijët, si pjesë e pambrojtur e shoqërisë, të cilët pa vullnetin e tyre detyrohen të kryejnë punë të pandershme, blihen dhe shiten për qëllime të ndryshme dhe detyrohen të ofrojnë kënaqësi seksuale personave të ndryshëm. Trafikimi i qenieve njerëzore mund të ndodhë brenda vendit, por edhe shpesh në vende tjera jashtë shtetit.<sup>53</sup>

Zakonisht fëmijët bëhen viktimë e këtyre grupeve, duke u mashtruar nga persona të rritur dhe të panjohur me identitet të rrejshëm, të cilët mund t'ju premtojnë dhurata luksoze, para jetë më të mirë brenda ose jashtë vendit, apo të japin arsye që mund t'ju duken interesante dhe aspak të rrezikshme. Personat e përfshirë në këtë krim janë shumë profesionalë, që në shumicën e rasteve mund të duken apo tingëllojnë si njerëz shumë të mirë dhe nuk mund t'i bëjnë keq dikujt, aq më pak një fëmije.

Këto ngacmime mund të ndodhin në jetën reale, por edhe në internet, përmes kanaleve të komunikimit, si: rrjetet sociale, mesazhe të menjëhershme ose dhoma diskutimi (Instant Messenger – IM / Chat rooms). Andaj, gjithmonë duhet të keni kujdes me kë bisedoni në internet dhe në rrugë. Asnjëherë mos

---

<sup>53</sup> [http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2011/01/110111\\_cyberbullying\\_children.shtml](http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2011/01/110111_cyberbullying_children.shtml), Botuar: E martë, 11 janar 2011 - 15:05 CET, Nina Robinson .Korrespondente e BBC-së. Marrë nga interneti ne qershor 2015.

lejoni që një i panjohur të jetë pjesë e profilit tuaj në rrjetet sociale dhe mos pranoni të bisedoni me ta në kanalet e ndryshme të komunikimit në internet. Aq më pak informatat tuaja personale, si: numri i telefonit, adresa elektronike (e-mail), adresa e shtëpisë, etj., t'u jepen personave të panjohur në internet.<sup>54</sup>

Nëse ndonjëherë ballafaqoheni me një dukuri të tillë, menjëherë duhet t'i njoftoni prindërit tuaj apo familjarët e tjerë që të ju dalin menjëherë në ndihmë dhe ta parandalojnë këtë gjë që mund t'ju vërë në rrezik eventual. Gjithashtu, mund të lajmëroni Policinë e Kosovës, duke thirrur në numrat: 192 dhe 922 nga telefoni celular (vala/ipko) dhe në numrin 92 nga telefoni fiks, si dhe mund t'i shkruani mesazh elektronik në adresën [info@kosovopolic.com](mailto:info@kosovopolic.com)

### **3.8. Pasojat e trafikimit – abuzimi seksual ndaj fëmijëve**

Abuzimi seksual ndaj fëmijëve është formë e detyrimit për marrëdhënie seksuale ndaj një fëmije nga një person i rritur. Abuzimi seksual mund t'u ndodhë meshkujve dhe femrave që mund të kryhet edhe përmes internetit dhe në realitet. Kjo dukuri në të gjitha mënyrat konsiderohet krim dhe totalisht ilegale.

Cilat janë format e abuzimit seksual: prekjet pa miratim tuaj, detyroheni të kryeni marrëdhënie seksuale, detyroheni të shikoni fotografi ose video me motive erotike, detyroheni të bëni biseda me motive seksuale, etj. Të gjitha këto mund të ndodhin në

---

<sup>54</sup> [http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2011/01/110111\\_cyberbullying\\_children.shtml](http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2011/01/110111_cyberbullying_children.shtml), Botuar: E martë, 11 janar 2011 - 15:05 CET, Nina Robinson. Korrespondente e BBC-së. Marrë nga interneti ne qershor 2015

realitet apo përmes kamerave në internet edhe pa fajin dhe dëshirën tuaj.

Por, edhe atëherë kur këto gjëra ju ndodhin, nuk duhet menduar se është faji juaj. Askush nuk ka të drejtë të abuzojë dikë me motive seksuale. Andaj nëse ballafaqoheni me këtë dukuri patjetër duhet të komunikoni me prindërit, të cilët do t'ju ndihmojnë që ta ndalin personin që ju detyron të bëni gjëra të tilla. Nuk ka rëndësi kush është ai person, shoku, shoqja, familjari, i dashuri, e dashura, i panjohuri etj. Gjithmonë një dukuri e tillë duhet të tregohet dhe të parandalohet menjëherë.

Nëse ndonjëherë ballafaqoheni me një dukuri të tillë, menjëherë duhet t'i njoftoni prindërit tuaj apo familjarët tjerë që t'ju dalin menjëherë në ndihmë dhe ta parandalojnë këtë gjë që mund t'ju vërë në rrezik eventual. Gjithashtu mund të lajmëroni Policinë e Kosovës duke thirrur në numrat 192 dhe 922 nga telefoni celular (Vala/Ipko) dhe në numrin 92 nga telefoni fiks, si dhe mund t'i shkruani mesazh elektronik në adresën [info@kosovopolic.com](mailto:info@kosovopolic.com)

### **3.9. Ngacimet kibernetike, rrezik për fëmijët<sup>55</sup>**

Kur fëmijët i dërgojnë njëri-tjetrit mesazhe përmes internetit, ose në telefonat e tyre, në përpjekje për të ngacmuar, turpëruar dhe kërcënuar njëri-tjetrin, kjo gjë njihet si ngacmime kibernetike. Në një studim të fundit amerikan, një ndër pesë të rinj (kjo gjë është vlefshme edhe në Britani) e kanë provuar një gjë të tillë. Në disa raste ekstreme ngacmime të tilla kanë çuar edhe në vetëvrasje.

---

<sup>55</sup> [http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2011/01/printable/110111\\_cyberbullying\\_children.shtml](http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2011/01/printable/110111_cyberbullying_children.shtml), Botuar: E martë, 11 janar 2011 - 15:05 CET Nina Robinson-Korrespondente e BBC-së. ( Marrë nga interneti në qershor 2015)

**Historia e Georgias-** Disa vjet me parë, kur Georgia ishte 12 vjeç, ndarja me një grup shokësh çoi në një fushatë të dhimbshme mesazhesh kundër saj, të dërguara me telefon edhe përmes internetit. "Kur kthehesha nga shkolla dhe kontrolloja mesazhet, atje gjeja 3-10 mesazhe në ditë, në të cilat thuhej se më kishin inat. Në shkollë nuk ndihesha e sigurt, por mesazhet më bënin të mos ndihesha mirë as në shtëpinë time," tregon Georgia. "Fillimisht i fshija mesazhet. I lexoja njëherë, psi mund të kishte diçka tjetër. Unë doja ta dija se çfarë thoshin për mua. Nuk doja ta dëgjoja nga të tjerët," tregon vajza. Një i ri tjetër, që ka provuar ngacmime të tilla kibernetike, është edhe djali trembëdhjetëvjeçar i Sally Cope. "Kur flas me rinjtë i pyes përse nuk e fikin kompjuterin? Por, është një farë impuls i frikshëm që i shtyn të marrin vesh se çfarë thonë të tjerët për ta".

"Kur unë kam qenë në shkollë ngacmimet bëheshin në oborrin e shkollës, ose rrugës për në shtëpi, por tani këto ngacmime ndodhin në shtëpinë tënde, që në fakt duhet të jetë një vend i sigurt, e që nuk është", thotë Sally Cope. Georgia thotë se te mesazhet problemi qëndron në faktin që ato perceptohen në mënyrë tjetër, pasi nuk ka zë, nuk ka tonalitet. Megjithatë, Georgias i pëlqen mesazhet e shpejta, atje nuk ka kufizime, shton ajo.

Sonia, 18-vjeçare, i ka përdorur faqet sociale në internet që kur ishte 13 vjeç dhe ajo i shikon kështu ngacmimet kibernetike: "Ata thonë gjëra, por në shkollë sy më sy nuk thonë asgjë, ata mendojnë se bëhen të këqij të fshehur pas kompjuterëve."

**Këshillim për t'u mbrojtur-** Jim Gamble drejton Njësinë britanike që lufton shfrytëzimin e fëmijëve përmes internetit. Ai përpiqet që t'i edukojë të rinjtë që të jenë më të përgjegjshëm



lidhur me atë që thonë dhe bëjnë në internet."Nëse njerëzit besojnë se ka pasoja për sjelljen e tyre, atëherë ka më pak gjasa që ata të përfshihen në këtë", thotë ai."Në realitet fëmijët hyjnë në internet në moshë të re, por disa faqe interneti sociale thonë se kushtet e pranimit e bëjnë të qartë që duhet të jesh të paktën 13 vjeç. Ju e dini, fëmijët thonë që janë 13, por mund të jenë 12 apo 11 vjeç dhe na duhet ta njohim këtë realitet", thotë zoti Gamble.Lily Rowland, që është 12 vjeç, thotë se dikush kishte hyrë në postën e saj elektronike dhe i kishte dërguar të tjerëve mesazhe të këqija, gjë që bëri që të dukej sikur ajo i kishte dërguar mesazhet."Mesazhet ishin të pahijshme si për shembull "le nam gjatë orës së mësimi". Të gjithë i bëjnë këto gjëra dhe i quajnë dhunim të 'Facebook'-ut", tregon Lily.

Hyrja në profilet private të të tjerëve në faqet sociale në internet, për të dërguar mesazhe, apo thjesht për të shkruar për veten, mund të çojnë në keqkuptime serioze.Por, Sonja 18-vjeçare, që ka mbi 600 miq në 'Facebook', thotë se e ka parë të ndodhë shpesh si shaka.

"Diçka që mund të shkruhet nga të tjerët në statusin tënd është "jam homoseksualë". Një mesazh në 'Halloween' ishte "I kam qejf burrat që veshin kostum të 'Halloween'-it. Budallaqe të tilla i shoh gjithmonë", thotë ajo.Ngacmimet kibernetike për Georgian vazhduan, derisa një ditë gjatë një ore mësimi ajo shkoi në banjë në përpjekje për t'i dhënë fund gjithçkaje."Unë mendova se nëse nuk isha këtu të gjithë do të ishin të lumtur", tregon ajo.Djali i Sally Cope, si Georgia, u përpoq të vetëvritej dhe tragjikisht ia arriti.Askush nuk u gjykua për rastin e tij, por Jim Gamble mendon se ligji duhet të veprojë edhe mbi ata që kryejnë ngacmime kibernetike."Nuk kemi nevojë për një ligj të ri, kemi nevojë për mendësi të reja", thotë ai.

"Duhën identifikuar çështjet e duhura dhe ato të gjykohe. Është çështje e ndjeshme, sepse një gjë e veçantë që arrihet, përveç të tjerave, është fakti që krijon parandalim", thotë zyrtari britanik për luftën kundër shfrytëzimit të fëmijëve në internet.<sup>56</sup>



---

<sup>56</sup> [http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2011/01/printable/110111\\_cyberbulling\\_children.shtml](http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2011/01/printable/110111_cyberbulling_children.shtml), Botuar: E martë, 11 janar 2011 - 15:05 CET, Nina Robinson-korrespondente e BBC-së. Marrë nga interneti ne qershor 2015

## IV. PËRFUNDIME

- Në shkollat tona ekziston gjuha urrejtëse te nxënësit e moshës 14/15-vjeçare, sipas hulumtimit të realizuar;
- Është evidente gjuha e urrejtëse te grupmosha 14/15-vjeçare sidomos përmes rrjeteve sociale, përmes komenteve negative, sms, por edhe publikimit të fotografive apo videove.
- Janë evidente ngacmimet ‘online’, ku pastaj shkaktohen edhe konflikte verbale dhe fizike në komunitet apo në shkollë.
- Zakonisht rastet e tilla nuk raportohen, apo nuk diskutohen me mësimdhënës apo staf profesional të shkollës e as me prindër, diskutimet bëhen me shokë të shkollës, pastaj ata i raportojnë ose jo rastet në fjalë.
- Edhe në raste të raportimit stafi i shkollës apo mësimdhënësit ende nuk kanë ndërmarrëdonjëmase për parandalim të gjuhës urrejtëse ‘online’/ ‘offline’.
- Nuk ekziston një aftësim nga ana e mësimdhënësve se si të reagojnë në këto raste dhe si t’i mbrojnë apo parandalojnë.

## V. REKOMANDIME

- Ndërgjegjësimi i prindërve lidhur me pasojat që mund të ketë gjuha urrejtëse në internet dhe në mediet sociale duhet të rritet. Kjo mund të bëhet me rritjen e njohurive për llojet e rreziqeve që fëmijët e tyre mund të hasin gjatë qëndrimit ‘online’ dhe gjatë shfrytëzimit të mjeteve elektronike;
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi i mësuesve në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga gjuhaurrejtëse, që do të rezultonte në edukimin e fëmijëve për përdorim të sigurt të mjeteve digjitale nëpër shkolla;
- Politikëbërësit duhet të sponsorojnë më shumë hulumtime rreth përdorimit të internetit, sigurisë ‘online’ dhe rreziqeve që lidhen me përdorimin e internetit;
- Industria duhet t’u ofrojë më shumë mbështetje programeve dhe aktiviteteve për sigurinë në internet dhe për të mbrojtur fëmijët në internet, duke ofruar mundësi filtrimi, bllokimi, raportimi, përmes të ashtuquajturve ‘Parental Control’ dhe ‘Technical tools’;
- Më shumë ndihmë duhet t’u ofrohet fëmijëve dhe prindërve lidhur me njohuritë e duhura për të bërë bllokimin e përmbajtjeve të padëshiruara që shfaqen aksidentalisht, për shembull fotografitë, filmat apo videot me përmbajtje të papërshtatshme për moshën e tyre;

- Të rritet vetëdijesimi i stafit profesional në shkolla, mësuesve dhe prindërve, në mënyrë që të reagojnë dhe tëndihmojnë fëmijët në rastet e përdorimit të gjuhësurrejtëse ‘online’ dhe ‘offline’;
- Hartimi i një platforme trajnimit për prindër, mësues, staf profesional dhe nxënës për ngritjen e kapaciteteve për pasojat e gjuhës e urrëjtëse ‘online’ dhe ‘offline’ dhe pasojat që rrjedhin nga kjo çështje.

## VI. LITERATURA

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008.
2. LIGJI PËR FAMILJEN I KOSOVËS meNr. 2004/32,GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË PÛRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË/PRISHTINË: VITI I/NR. 4/01, SHTATOR 2006.
3. GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 25 / 07 SHTATOR 2012, PRISHTINË, Kuvendi i Republikës së Kosovës; Në bazë të nenit 65 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
4. GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.19 / 13 KORRIK 2012, PRISHTINË KODI NR. 04/L-082, KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS.
5. LIGJI PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE NË REPUBLIKË.LIGJI NR. 03/L-047, DATË 13.03.2008.
6. Ligji Nr. 05/L -020, PËR BARAZI GJINORE, Kuvendi i Republikës së Kosovës; në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 28 maj 2015.
7. Ligji PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, Kuvendi i Republikës së Kosovës; në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L -021 28 maj 2015.
8. BOOKMARKS -A MANUAL FOR COMBATING HATE SPEECH ONLINE THROUGH HUMAN RIGHTS EDUCATION B, Written and edited by Ellie Keen, Mara

Georgescu Final editing Rui Gomes, Printed in Hungary  
ISBN 978-92-871-7840-4 © Council of Europe, 2014.

9. Sadurkski, 'Partnering with Strasbourg: Constitutionalisation of the European Court of Human Rights, the Accession of Central and East European States to the Council of Europe, and the Idea of Pilot Judgments', 9 Human Rights Law Review (2009) 397.
10. GJEDNJ, *Bączkowski dhe të tjerët kundër Polonisë* (Nr. 1543/06), 3 Maj 2007 (ECtHR, *Bączkowski and others v. Poland* (No. 1543/06), 3 May 2007).
11. Preventing and Responding to Hate Crimes: A Resource guide for NGOs in the OSCE region, OSCE/ODIHR, 2009;
12. Hate Crime Laws: A Practical Guide, Published by ODIHR, Warsaw, Poland, 2009
13. The Camden Principles on Freedom of Expression and Equality, April, 2009;
14. Korniza e Kurrikulit të Kosovës, Prishtinë 2011.
15. Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtëse, autorë: dr. Elena Mihajlova dr Jasna Bačovska mr. Tome Shekerxhiev, Shkup, 2013, (Deklarata për Parimet Themelore për Kontributin e Mediave në Përforcimin e Paqes dhe Mirëkuptimin Ndërkombëtar, për Avancimin e të Drejtave të Njeriut dhe Luftimin me Racizmin, Aparthedin dhe Nxitjen e Luftës, UNESKO, 1978 ).
16. Manual për Ligjin Evropian të Mbrojtjes nga Diskriminimi, korrik 2010. Ky përkthim u mundësua në kuadër të Projektit të Përbashkët mes Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, i titulluar «Përforcimi i Mbrojtjes së të Drejtave të

- Njeriut në Kosovë’ Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore të Njeriut, 2010. Këshilli i Evropës, 2010.
17. MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI MANUAL TRAJNIMI PËR OJF-të, Dr. Irma Baraku, Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Kreu 1), Prof. As. Arta Mandro, TIRANË, 2013.
  18. **Zguri Rrapo**, “Publiku në udhëkryqin media klasike – internet”.  
Linku:<http://mediapermedian.wordpress.com/2012/11/27/publiku-në-kryqezimin-media-klasike-internet>.

---

1. Marrë më 08.04.2015 nga interneti:  
<http://www.respublica.al/artikuj/2014/09/23/sociologethone-se-rrjetet-sociale-po-keqperdoren-ne-nxitjen-e-urrejtese>.

2. <http://koha.net/?id=3&l=50848>,  
<https://youtu.be/yYpdAsivUE4>.

---

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=130667>.

3. [http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2011/01/110111\\_cyber\\_bulling\\_children.shtml](http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2011/01/110111_cyber_bulling_children.shtml). Botuar nga Nina Robinson. Korrespondente e BBC-së

---

4. <http://femijet.gov.al/wpcontent/uploads/2016/02/Broshura-F%C3%ABmij%C3%AB-t%C3%AB-sigurtan%C3%AB-internet.pdf>



## **SHTOJCA- 1**

### **FJALORTH**

**Antisemitizmi:** Urrejtja, paragjykimi, shtypja apo diskriminimi kundrejt hebrenjve dhe hebraizimit. Faktikisht, termi është i gabuar. “Semitik” do të thotë në mënyrë origjinale pasardhësit e Shem-it, ku përfshihen hebrenjtë dhe myslimanët e Lindjes së Mesme. Tani termi përdoret kryesisht që t’u referohemi hebrenjve.

**Aparteidi:** Aparteidi është një fjalë afrikane për diskriminimin sistematik dhe të legalizuar që ekzistonte në Afrikën Jugore në mes viteve 1948 – 94. Nën Aktin e Regjistrimit të Popullsisë së vitit 1950, popullsia ishte klasifikuar në kategori të ndryshme racore, me edukim dhe vendbanim. Edhe martesat ishin të lejuara përbrenda kategorisë së njëjtë. Me zgjedhjen e Nelson Mandelës president, në vitin 1994, sistemi u zhvesh legalisht, edhe pse disa veprime të ngjashme me ato të aparteidit ende vazhdojnë jozyrtarisht.

**Arbitrazh(Ligj):**Dëgjimi dhe përcaktimi i një mosmarrëveshjeje, në veçanti një mosmarrëveshjeje industriale, ndërmjet dy palëve të ndryshme me anë të një komisioni arbitrazhi (e drejta ndërkombëtare), procedura e përcaktuar për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare.

**Arsimimi:** Disiplinë që kujdeset, në këtë kontekst, kryesisht me metodat e mësimin dhe të nxënimit në shkollat dhe në ambiente shkollore, si negacion i mjeteve të ndryshme jozyrtare të socializimit (p.sh. në mes prindërve dhe fëmijëve të tyre).

**Barazia:**Parimi sipas të cilit të gjithë njerëzit janë të barabartë, gjegjësisht të barabartë në obligimet dhe të drejtat. Barazia nënkupton llojllojshmëri, gjegjësisht nënkupton ekzistimin e subjekteve të ndryshme, të cilat duhet të trajtohen njëjloj.

**Besimi:** Një fe, apo cilado bashkësi e besimit fetar.

**Bindja:** Sistem i të kuptuarit dhe vlerave të një njeriu,të cilat e udhëheqin në jetë, në kuadër të të cilave e definojnë dallimin mes së mirës dhe së keqes. Në sistemin e bindjeve marrin pjesë bindjet religjioze dhe ideologjike, por vetë fjala ka rëndësi shumë të gjerë dhe në vete i inkorporon të gjitha llojet e ateizmit, skepticizmit, antiteizmit.

**Cyber bullying ose Sajberdhuna:** Terminologji në gjuhën angleze, që përdoret kur njerëzit përdorin internetin për të kërcënuar, ngacmuar, apo poshtëruar dikë, duke dërguar mesazhe të këqija, fotografi dhe video tronditëse të personat e panjohur. Ka shumë forma të ‘cyber bullying’, mirëpo këto janë më të shpeshtat.

**Diskriminim:** Refuzimi i trajtimit të barabartë të lirive civile, apo mundësive për individë apo grupe në lidhje me arsimimin, banimin, kujdesin shëndetësor, punësimin, apo qasjen në shërbime, në të mira apo ndihma. Diskriminimi mund të shfaqet në baza racore, nacionale, gjinore, moshe, religjioze, politike, apo të bashkimeve etnike, statusit martesor apo familjar, fizik, në baza zhvillimore, apo të hendikepit mental.

**Diskriminimi direkt:** Shfaqet kur një person apo grup njerëzish merr një trajtim më të pafavorshëm sesa një person apo grup në pozicion të njëjtë, të cilët kanë marrë në bazë të racës së tyre, ngjyrës dhe prejardhjes së tyre nacionale dhe etnike.

**Diskriminimi indirekt:** Përfshin praktikat dhe politikat, të cilat mund të shfaqen si “neutrale” apo “të paanshme”, por që ndikojnë pafavorshëm në një pjesë të madhe të njerëzve të një race, nacionaliteti apo grupi etnik. Gjithashtu, mund të duket se ata nuk ka kurrfarë qëllimi për diskriminim.

**Dhuna seksuale:** Sjellje e orientuar në bazë gjinore, e cila ka për qëllim të lëndojë apo të vrasë dikë.

**Etnocentrizmi:** Proces i vënies së theksit më shumë mbi teoritë dhe idetë evropiane (dhe në përgjithësi perëndimore), në llogari të kulturave të tjera. Nënkuptimi i këtij definicioni është supozimi se konceptet perëndimore janë në thelb të ndryshme nga ato të kulturave dhe civilizimeve të tjera. Po ashtu, është një nënkuptim kontradiktor i supozimit se konceptet perëndimore janë universale. Kështu, ata kanë evoluar në një përdorim universal kulturor, në të cilin elementet e tjera kulturore lehtë mund të ndërrohen. Është në numër i koncepteve të tilla perëndimore, gjithmonë në proces të vërshimit. Zakonisht idetë e definuara si perëndimore përfshijnë individualizmin, të drejtat e njeriut, autoritetin laik dhe ligjin, si dhe ndarjen e religjionit nga shteti.

**Fëmija:** Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara e vitit 1989 e definon fëmijën si “qenie njerëzore nën moshën 18-vjeçare, përveç nën ligjin e aplikueshëm ndaj fëmijës, mosha madhore e të cilit është e arritur më herët”.

**Forumet:** Vende virtuale në internet, ku njerëzit mund të postojnë mesazhe në lidhje me një temë. Njerëzit me interesa të ngjashme mund të lexojnë mesazhet dhe postojnë përgjigje.

**Grup i marginalizuar:** (I dobët), (përkritja në një grup të marginalizuar si bazë për diskriminim), grup i individëve të cilët

i bashkon pozita specifike në shoqëri (jashtë nga qendrat e fuqisë, të ekspozuar në përjashtim social), të cilët janë objekt i paragjyqimeve, kanë karakteristika të veçanta dhe të cilët i bëjnë të volitshëm për lloje të dhunës së caktuar, kanë mundësi më të vogël për praktikumin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, ose janë të ekspozuar nga mundësia e madhe për viktimizim të mëtejshëm.

**Gjinia:** Neni 7, paragrafi 3 i Statutit të Romës për Gjykatën Kriminale Ndërkombëtare e definoi gjininë si “dy sekset, mashkullore dhe femërore, në përbërje të shoqërisë. Termi “gjinia” nuk do të ketë asnjë kuptim nga të lartpërmendurit”. Definicionet më liberale po ashtu mund të përfshijnë pozitat shoqërore lidhur me femra dhe meshkuj.

**Gjuha:** (Si bazë e diskriminimit). Me gjuhën nënkuptohet çdo sistem i komunikimit mes njerëzve, nëpërmjet të cilit me përdorimin e zërit, trupit ose simboleve, njerëzit i shprehin idetë dhe mendimet e tyre dhe i shkëmbejnë me të tjerët.

**Gjuha urrejtëse:** Siç është e definuar nga ana e Këshillit Evropian, i përfshin të gjitha format e shprehjes, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje racore, ksenofobi, antisemitizëm ose në forma të tjera urrejtëse në bazë të jotolerancës, duke përfshirë: jotolerancën e shprehur përmes nacionalizmit agresiv dhe etnocentrizmit agresiv, diskriminimi dhe armiqësia kundër pakicave, emigrantët dhe personat me prejardhje emigrante.

**Gjenocidi:** Shkatërrimi i qëllimshëm dhe sistematik i një grupi racor, etnik, religjioz apo kulturor, përmes vrasjeve, lëndimeve, keqësimit të kushteve jetësore, ndalimit të prejardhjes apo lindjes së fëmijëve.

**Homofobia:** Qëndrim irracional, mosdurim dhe urrejtje e drejtuar nga homoseksualët dhe lezbejkat. Bindje tipike homofobike është se homoseksualiteti është i panatyrshëm, se është sëmundje, perversion, i rrezikshëm.

**Interneti:** Një rrjet global i kompjuterëve të lidhur, që janë në gjendje të komunikojnë nëpërmjet kablllove, linjave telefonike dhe satelitëve.

**Intoleranca:** Mosdëshirueshmëria për të rezistuar apo për të respektuar besimet dhe praktikat e të tjerëve. Intoleranca racore ndalon njerëzit e grupeve të tjera racore që të përdorin bashkë barazinë apo përfitimin e plotë nga shanset e mundshme në bashkësi, përderisa intoleranca fetare refuzon të pranojë apo të respektojë besimet fetare të të tjerëve.

**Krim kibernetik:** Krimi kibernetik lidhet me një aktivitet kriminal të zhvilluar në rrjet (internet).

**Konventa:** Marrëveshje ndërmjet shteteve për zbatimin e ligjit të njëjtë për ndonjë çështje specifike. Kur një shtet e nënshkruan dhe e ratifikon (miraton) një konventë, ajo bëhet premtim ligjor dhe i orienton veprimet e Qeverisë. Shpeshherë e orienton Qeverinë për adaptimin dhe ndryshimin e ligjeve nacionale për t'i mbështetur qëllimet e konventës.

**Ksenofobia:** Ksenofobia është urrejtja dhe frika nga të huajt. Kur këto ndjenja janë të shpërndara te një pakicë e dukshme, shprehja 'racizëm' përdoret shpesh. Është ndoshta më mirë që të shohin 'racizmin' si një rast të veçantë të ksenofobisë dhe pastaj ta përdorim atë lirshëm.

**Ngacmimi:** Shqetësim, duke prekur me dorë, duke i thënë fjalë që e mërzhitin, ose duke tallur, trazuar e cypur dike për të zemëruar, thumbuar (diçka që na shqetëson).

**Ngacmues:** Ai që ngacmon dikë, apo diçka (që ngacmon të tjerët me fjalë ose vepra).

**Nxitja e diskriminimit:** Aktivitetet me të cilat dikush në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë inkurajon, jep udhëzime, kërcënohet, bën presion ose bind dikë të bëjë diskriminim, kur pala e cila nxit është në pozitë të ndikojë mbi palën ndaj së cilës nxitet.

**Racizmi individual:** Formë e diskriminimit racor, i cili rrjedh nga paragjykimet e ndërgjegjshme personale nga individët.

**Paragjykimi:** Kornizë mendore, e cila priret të paragjykojë një person apo grup në dritë negative. Këto gjykime negative zakonisht bëhen pa ndonjë fakt adekuat. Këto qëndrime negative shpesh njihen si supozime të njëzëshme, për arsye të frekuencës me të cilën janë përsëritur. Ato bëhen nocione të “ gjykimit të shëndoshë”, të cilat pranohen në masë të gjerë dhe përdoren për justifikimin e akteve të diskriminimit.

**Raca:** Termi ‘racë’ është një strukturë artificiale, e përdorur për klasifikimin mbi baza të ngjashmërisë fizike dhe kulturore të njerëzve që kanë prejardhje të përbashkët. Shkenca moderne ka treguar se kategorizimi biologjik i racës është i pakuptimtë kur aplikohet në qeniet njerëzore. Qeniet njerëzore biologjikisht kanë kode të njëjta gjenetike dhe nuk ka dallime gjenetike ndërmjet të ashtuquajturave grupe racore apo në mes tyre. Nganjëherë, kjo ideologji është bazë e veprimit shoqëror, themelim i politikës së

vendit dhe shpesh një justifikim për trajtim dallues të një grupi ndaj tjetrit.

**Racizmi:** Një grup i gabuar i supozimeve, mendimeve dhe veprimeve që rrjedhin nga besimi se një grup është më superior sesa tjetri. Racizmi u drejtohet jo vetëm pozicionimeve shoqërore kundrejt pakicave etnokulturore, por edhe strukturave shoqërore, të cilat përjashtojnë gupet apo individët e tillë. Racizmi mund të shfaqet në strukturat dhe programet organizative dhe institucionale, si dhe në qëndrimet dhe sjelljet e individëve.

**Të drejtat e njeriut:** Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të lindur me të drejta dhe dinjitet të barabartë. Askush nuk është i përjashtuar. Për shembull, çdo qenie njerëzore ka të drejtë të jetës dhe liri nga skllavëria (robëria). Këto të drejta janë konfirmuar në Deklaratën universale për të drejtat e njeriut, në vitin 1948. Të gjithë fëmijët e gëzojnë të drejtën për ushqim dhe përkujdesje shëndetësore, të drejtën për shkollim dhe atë për mbrojtje nga dhuna dhe abuzimi. Fëmijët po ashtu kanë të drejtë të thonë se çka mendojnë kur të rriturit marrin vendime, të cilat kanë efekt ndaj tyre, gjegjësisht kanë të drejtë të merret në konsideratë opinioni i tyre. Të drejtat e fëmijëve janë të theksuara në Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

**Ratifikimi:** Akt i pranimit të një dokumenti të caktuar ndërkombëtar në legjislacionin kombëtar. Zhvillohet nëpër procesin që është i njëjtë me procesin e miratimit të ligjeve kombëtare.

**Trafikimi i qenieve njerëzore:** Është një lëvizje e ndaluar dhe e fshehtë e njerëzve në kufij kombëtarë dhe ndërkombëtarë, më së shumti nga shtetet në zhvillim dhe nga disa shtete në tranzicion, me një qëllim përfundimtar për detyrimin e femrave, vajzave dhe

fëmijëve në situata të shfrytëzimit seksual apo ekonomikisht shtypëse dhe shfrytëzuese për përfitime nga rekrutuesit, trafikantët, sindikatat e krimit, si dhe aktivitetet e tjera ilegale të ndërlidhura me trafikim, siç është puna e detyruar.

**Shqetësimi:** Çdo sjellje e padëshiruar lidhur me ndonjërin nga bazat e diskriminimit, pavarësisht nga ajo nëse manifestohet në mënyrë fizike, verbale ose tjetër, që është e drejtuar ose ka për qëllim, shkeljen e dinjitetit të një personi të caktuar ose krijimin e mjedisit, qasjes ose praktikës kërcënuese, armiqësore, degraduese, ofenduese ose frikësuese

**Shqetësimi seksual:** Lloj i diskriminimit që karakterizohet me sjellje të padëshiruar me karakter seksual, që manifestohet në mënyrë fizike, verbale ose tjetër, ndërsa ka për qëllim të shkaktojë shkeljen e dinjitetit të personit dhe/ose të krijojë armiqësi, rrethim kërcënues dhe poshtëruës, veçanërisht kur refuzimi të pranohet sjellja e tillë, ose presioni që të pranohet, mund të ndikojë në miratimin e vendimeve, të cilat do të kenë ndikim ndaj atij personi.



## **Botues**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

## **Shtypi**

Shtypshkronja “SOLAR”Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37:659.3(048.8)

Bajrami-Shala, Luljeta

Gjuha urrejtëse e nxënësve në mediet sociale : (si ta parandalojmë) : doracak për mësues / Lujeta Bajrami-Shala. – Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2016. – 98 f. : ilustr. me ngjyra; 21 cm.

Parathënie / Ismet Potera : f. 5-7. – Literatura : f. 86-88

**ISBN 978-9951-591-31-7**